

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.3/4, Mars - Prill 2016

RRËSHAJËT: E KREMTJA E MREKULLIVE

Rrëshajët ose Rrushajët (greq. πεντεκοστή - pentekoste - "e pesëdhjeta (ditë). Është festa ditën e 50 pas Pashkëve dhe 10 ditë pas festës së Ngjitjes së Jezusit në qiell. Është festë e lëvizshme në varësi të Pashkëve. Këtë vit festa kremtohet me 15 maj.

Festa e Rrëshajave rrjedh nga festa hebraike Shavut. Si festë e krishterë përmendet për herë të parë në vitin 130. Rrëshajat është festa e dërgimit të Shpirtit të Shenjtë apostujve të Krishtit dhe është fillimi i krijimit (themelimit) zyrtar të kishës së Krishtit. Kjo përshkruhet në Besëlidhjen e Re, Vepr. 2:1 :(Dhe kur dita e rrëshaje vë erdhi plotësisht, ata të gjithë me marrëveshje ishin mbledhur në një vend. Dhe papritur erdhi një zë nga qielli si një erë vërsulëse e fuqishme, dhe mbushi të gjithë shtëpinë ku ata po rrinin. Dhe tek ata u shfaqën gjuhëza të çara si ato të flakës, dhe u ul mbi secilin prej tyre. Dhe ata u mbushën të gjithë nga Shpirti i

Shenjtë dhe nisën të predikojnë në gjuhë të tjera, siç i urdhëronte Shpirti). Me "mrekulli të Rrëshajëve" tregohet aftësia e mrekullueshme e apostujve për të folur dhe kuptuar të gjitha gjuhët. Me këtë ngjarje u hoq nga pikëpamja e krishtere "gjuhë çoroditja babilonike", me të cilën Perëndia ndëshkoi njerëzit për kryelartësinë e tyre në ndërtimin e kullës së Babelit. Teologjikisht mrekullia e Rrëshajëve është misioni i Kshës, t'ju drejtohet në gjuhën e tyre të gjithë njerëzve, pavarësisht nga kombësia dhe raca. Kishat Pentekostale të krishtera të cilat quhen kështu (Rrëshajore) sepse theksojnë Shpirtin e Shenjtë në çdo njeri, dhe i kremtojnë Rrëshajët si përvjetor i të mbushurit me Shpirtin e Shenjtë të dishepujve, siç përshkruhet në Besëlidhjen e Re tek Vepr. 2:17. Kremtimi i Rrëshajëve bëhet edhe nga Kisha të tjera. Në Kishën katolike romake dhe në ato të Lindjes, festën e Dielës së Rrëshajëve kremtohet me madhësi.





Papa Fraçesko FITO MBI INDIFERENCËN	4
Redaksia DIVINI REDEMPTORIS	8
Don Lush Gjergji ATENAGORA I	10
Don Nosh Gjolaj KULTIVIMI I SINQERITETIT	12
Jaho Brahaj ORIGJINA E GJON BUZUKUT	16
Admirina Peçi PSE MJEDA NUK U DËNUA?	18
Nertila Haxhia - Ljarja PËRMBYSJA E SISTEMIT KOMUNIST	21
Kastriot Marku PROPAGANDA FIDE	24
Redaksia RROFTË KRISHTI MBRET! RROFTË SHQIPNIA!	27
VITRINA E LIBRIT	28

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXX, nr. 3/4 (483-484) Mars - Prill 2016

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Artur Jaku
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA
Fotografe: Luli Ndreu

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

FITO MBI INDIFERENCËN DHE ARRIJE PAQEN!

Mesazhi i Atit të shenjtë, Papa Françeko për ditën botërore të paqes 2016

(Pjesa e fundit)

Prej indiferencës të mëshira: kthimi i zemrës

Kur, një vit më parë, në Mesazhin për Ditën Botërore të Paqes: “Jo më sklevër, por vëllezër”, rikujtoja ikonën e parë biblike të vëllazërisë njerëzore, atë të Kainit dhe të Abelit (krh. Zan 4,1-16), ishte për të tërhequr vëmendjen se si është tradhtuar kjo vëllazëri e parë. Kaini dhe Abeli janë vëllezër. Vijnë të dy prej të njëjtit kraharor, janë të njëjtë në dinjitet dhe të krijuar në shëmbëlltëri dhe përngjasim të Hyjit; por vëllazëria e tyre si krijesa prishet. «Kaini jo vetëm nuk e duron vëllanë e vet Abelin, por e vret prej zilisë». Vëllavrasja atëherë bëhet forma e tradhtisë dhe mospranimi nga ana e Kainit e vëllazërisë me Abelin është prishja e parë në marrëdhëniet familjare të vëllazërisë, të solidaritetit dhe të respektimit të ndërsjellë.

Atëherë, Hyji ndërhyr për ta thirrur njeriun në përgjegjësi ndaj të afërmit të vet, pikërisht siç bëri kur Adami dhe Eva, prindërit e parë, prishën bashkësinë me Krijuesin.

«Atëherë Zoti e pyeti Kainin: “Ku është vëllai yt, Abeli?”. Ky i përgjigji: “Nuk di. Pse a mos jam

unë rojtari i tim vëllai?”. Zoti i tha: “Po çka bëre!? Zëri i gjakut të vëllait tënd bërtet tek unë prej dheut!”» (Zan 4,9-10).

Kaini thotë se nuk e di se çfarë i ndodhi të vëllait, thotë se nuk është rojtari i tij. Nuk ndihet përgjegjës për jetën e tij, për fatin e tij. Nuk ndihet i përfshirë. Është indiferent ndaj vëllait të vet, megjithëse ata janë të lidhur prej zanafillës së përbashkët. Çfarë trishtimi! Çfarë drame vëllazërore, familjare, njerëzore! Kjo është shfaqja e parë e indiferencës mes vëllezërve. Kurse Hyji nuk është indiferent: gjaku i Abelit ka vlerë të madhe në sytë e tij dhe i kërkon Kainit të japë llogari. Pra, Hyji zbulohet, qysh prej fillimit të njerëzimit, si Ai që interesohet për fatin e njeriut. Kur më vonë bijtë e Izraelit gjenden në skllavëri në Egjipt, Hyji ndërhyr sërish. I thotë Moisiut: «E pashë mjerimin e popullit tim në Egjipt dhe e dëgjova klithjen e tij për ndihmë për shkak të pashpirtësisë së mbikëqyrësve të tyre. Dhe, duke e ditur vuajtjen e tij, zbrita për ta çliruar nga duart e egjiptianëve, ta nxjerr nga ajo tokë dhe ta çoj në një



vend të mirë e të gjerë, në dheun ku rrjedh qumësht dhe mjaltë» (Dal 3,7-8). Është e rëndësishme të vihen re foljet që përshkruajnë ndërhyrjen e Hyjit: Ai sheh, dëgjon, njeh, zbret, liron. Hyji nuk është indiferent. Është i vëmendshëm dhe vepron.

Në të njëjtën mënyrë, në Birin e tij Jezus, Hyji ka zbritur mes njerëzve, është mishëruar dhe është treguar solidar me njerëzimin, në çdo gjë, me përjashtim të mëkatit. Jezusi identifikohet me njerëzimin: «vëllai i parë në mes të shumë vëllezërve» (Rom 8,29). Ai nuk mjaftohet vetëm duke mësuar turmat, por shqetësohet për ta, sidomos kur i shihet të uritura (krh. Mk 6,34-44) apo të papuna (krh. Mt 20,3). Shikimi i tij nuk u drejtohet vetëm njerëzve, por edhe peshqve të detit, zogjve të qiellit, bimëve dhe pemëve, të vegjëlve dhe të mëdhenjve; përqaftonte gjithë krijimin. Ai sheh, sigurisht, por nuk kufizohet me kaq, sepse prek personat, flet me ta, vepron në dobi të tyre dhe i bën mirë atij që ka nevojë. Jo vetëm, por e lë veten të mallëngjehet dhe të qajë (krh. Gjn 11,33-44). Dhe vepron për t'i dhënë fund vuajtjes, trishtimit, njerimit dhe vdekjes.

Jezusi na mëson të jemi të mëshirshëm si Ati (krh. Lk 6,36). Në shëmbëlltyrën e samaritanit të mirë (krh. Lk 10,29-37) denoncon mosdhënien e ndihmës përpara nevojës urgjente të të ngjashmëve të vet: «E pa, iu shmang e vazhdoi rrugën» (krh. Lk 10,31.32). Në të njëjtën kohë, nëpërmjet këtij shembulli, Ai i fton dëgjuesit e vet, dhe në veçanti nxënësit e vet, të mësojnë të ndalen përpara vuajtjes së kësaj bote për ta lehtësuar atë, përpara plagëve të të tjerëve për t'i mjekuar ato, me mjetet që kanë, duke u nisur nga koha e tyre, me gjithë punët e shumta të mund të kenë. Në fakt, indiferenca, shpesh kërkon pretekste: në zbatimin e normave rituale, në numrin e gjërave që duhen bërë, në antagonizmat që na mbajnë larg njëri-tjetrit, në paragjykimet e çdo lloji që na pengojnë të bëhemi të afërm.

Mëshira është zemra e Hyjit. Për këtë arsye duhet të jetë edhe zemra e të gjithë atyre që e njohin veten si pjesëtarë të një familjeje të madhe të vetme të bijve të tij; një zemër që rreh fort kudo ku dinjiteti njerëzor – pasqyrë e fytyrës së Hyjit në krijesat e veta – është në lojë. Jezusi na paralajmëron: dashuria për të tjerët – të huaj, të sëmurë, të burgosur, të pastrehë, madje edhe armiq – është e vetmja masë e Hyjit për të gjykuar veprimet tona. Prej kësaj varet fati ynë i amshuar. Nuk kemi pse të habitemi që Pali apostull i fton të krishterët e Romës të gëzohen me ata që gëzohen dhe të qajnë me ata që qajnë (krh. Rom 12,15), apo që i porosit

ata të Korintit të mbledhin ndihma në shenjë solidariteti me ata pjesëtarë të Kishës që vuajnë (krh. 1Kor 16,2-3). Dhe Shën Gjon shkruan: «Kush i ka të mirat e kësaj bote dhe e sheh vëllanë e vet në ngushticë dhe e mbyll zemrën e vet para tij – në ç'mënyrë dashuria e Hyjit qëndron në të?» (1Gjn 3,17; krh. Jak 2,15-16).

Ja pse «është përcaktuese për Kishën dhe besueshmërinë e kumtimit të saj që ajo ta jetojë dhe ta dëshmojë mëshirën në vetën e parë. Gjestet dhe të folurit e saj duhet të përçojnë mëshirë për të hyrë në zemrën e personave dhe t'i nxisë ata të rigjejnë rrugën për t'u rikthyer te Ati. E vërteta e parë e Kishës është dashuria e Krishtit. Për këtë dashuri, që arrin deri në faljen dhe dhurimin e vetes, Kisha bëhet shërbëtore dhe ndërmjetësuese pranë njerëzve. Prandaj, aty ku Kisha është e pranishme, aty duhet të jetë e dukshme mëshira e Atit. Në famullitë tona, në bashkësitë, në shoqatat dhe lëvizjet, me një fjalë, kudo që ka të krishterë, çdokush duhet të gjejë një oaz mëshire»

Kështu, edhe ne jemi të thirrur ta bëjmë dashurinë, dhembshurinë, mëshirën dhe solidaritetin një program të vërtetë jete, një stil sjelljeje në marrëdhëniet tona me njëri-tjetrin. Kjo kërkon kthimin e zemrës: domethënë që hiri i Hyjit ta shndërrojë zemrën tonë prej guri në një zemër prej mishi (krh. Ez 36,26), të aftë për t'iu hapur të tjerëve me solidaritet autentik. Kjo, në fakt, është më shumë se një «ndjenjë e vakët dhembshurie apo mallëngjimi sipërfaqësor për të këqijat e shumë personave, afër apo larg». Solidariteti «është vendosmëria e qëndrueshme dhe ngulmuese për t'u angazhuar për të mirën e përbashkët: apo për të mirën e të gjithëve dhe të secilit, sepse të gjithë jemi me të vërtetë përgjegjës për të gjithë», sepse dhembshuria buron prej vëllazërisë.

E kuptuar në këtë mënyrë, solidariteti përbën qëndrimin moral dhe shoqëror që më mirë i përgjigjet vetëdijësisë për plagët e kohës sonë dhe të ndër-varësisë së pamohueshme që gjithnjë e më shumë ekziston, sidomos në një botë të globalizuar, mes jetës së individit dhe bashkësisë së tij në një vend të caktuar dhe asaj të burrave e grave në vende të tjera të botës.

Të nxitësh një kulturë solidariteti dhe mëshire për të fituar mbi indiferencën

Solidariteti si virtut moral dhe qëndrim social, fryt i kthimit personal, kërkon një angazhim prej anës së shumë subjekteve, që kanë përgjegjësi të karakterit edukativ dhe formativ.

Mendimi im i parë shkon te familjet, të thirrura

për një mision parësor edukativ dhe prej të cilit nuk mund të heqin dorë. Ato përbëjnë vendin e parë ku jetojnë dhe përçohen vlerat e dashurisë dhe të vëllazërës, të bashkëjetesës dhe të bashkëndarjes, të vëmendjes dhe të përkujdesjes ndaj tjetrit. Ato janë edhe vende të privileguara për përçimin e fesë, duke filluar prej atyre gjesteve të para të thjeshta të devocionit që nënat u mësojnë fëmijëve të tyre.

Për sa u përket edukatorëve dhe formatorëve që, në shkollë apo në qendra të ndryshme ku mblidhen fëmijët dhe të rinjtë, kanë detyrën angazhuese për të edukuar fëmijët dhe të rinjtë, janë të thirrur që të jenë të vetëdijshëm që përgjegjësia e tyre ka të bëjë me përmasat morale, shpirtërore dhe shoqërore të personit. Vlerat e lirisë, të respektit të ndërsjellë dhe të solidaritetit mund të përçohen qysh në moshë të njomë. Duke iu drejtuar përgjegjësve të institucioneve që kanë detyra edukative, Benedikti XVI pohonte: «çdo mjedis edukativ të jetë një vend i hapur ndaj transhendentës dhe të tjerëve; vend

individuale. Mjetet e komunikimit, në fakt, «jo vetëm informojnë, por edhe formojnë shpirtin e spektatorëve dhe për këtë arsye mund të japin një ndihmë me vlerë në edukimin e të rinjve. Është e rëndësishme të kihet parasysh që lidhja mes edukimit dhe komunikimit është shumë e ngushtë: edukimi ndodh në fakt përmes komunikimit, që ndikon, pozitivisht apo negativisht, në formimin e personit. Operatorët kulturorë dhe të medias do të duhej edhe të vigjëlonin me qëllim që mënyra me të cilën merren dhe përhapen informacionet të jetë juridikisht dhe moralisht e ligjshme.

Paqja: fryt i një kulture solidariteti, mëshire dhe dhembshurie

Të vetëdijshëm për kërcënimin e një globalizimi të indiferencës, nuk mund të mos njohim që, në skenarin e sipërparaqitur, përfaqësohen edhe shumë nisma dhe veprime pozitive që dëshmojnë dhembshurinë, mëshirën dhe solidaritetin që njeriu është i aftë të tregojë. Do të doja të kujtoja disa shembuj të lavdërueshëm angazhimi, që tregojnë se si secili mund të fitojë mbi indiferencën kur zgjedh të mos e heqë shikimin prej të afërmit të vet dhe që janë praktika të mira në ecjen drejt një shoqërie më njerëzore.

Ka shumë organizata jo qeveritare dhe grupe bamirëse, brenda Kishës dhe jashtë saj, ku pjesëtarët e saj, në raste epidemish, tërmetesh apo konfliktesh të armatosura, u bëjnë ballë vështirësive dhe rreziqeve për të mjekuar të plagosurit e të sëmurët dhe për të varrosur të vdekurit. Përveç tyre, do të doja të përmendja personat dhe shoqatat që ndihmojnë emigrantët, që përshkrijnë shkretëtira dhe kapërcejnë dete për të kërkuar kushte më të mira pune. Këto veprime janë vepra mëshire trupore dhe shpirtërore, mbi të cilat do të gjykoheja në fund të jetës sonë.

Mendimi im shkon edhe te gazetarët dhe fotografët që informojnë opinionin publik mbi situatat e vështira që pyesin ndërgjegjet tona, si edhe te ata që angazhohen për mbrojtjen e të drejtave njerëzore, në veçanti ato të pakicave etnike dhe fetare, të popujve vendas, të grave dhe të fëmijëve, si edhe të të gjithë atyre që jetojnë në kushte cënueshmërie më të madhe. Mes tyre ka edhe shumë meshtarë dhe misionarë që, si barinj të mirë, qëndrojnë pranë besimtarëve të tyre dhe i mbështesin me gjithë rreziqet dhe vështirësitë, në veçanti gjatë konflikteve të armatosura.



dialogu, kohezioni dhe dëgjimi, në të cilin i riu duhet të ndihet i vlerësuar në potencialitetet e veta dhe në pasuritë e brendshme, si dhe duhet të mësojë t'i vlerësojë vëllazërit. Duhet të mësojë ta shijojë gëzimin që buron prej të jetuarit ditë pas dite dashurinë dhe dhembshurinë ndaj të afërmit dhe prej marrjes pjesë në mënyrë aktive në ndërtimin e një shoqërie më njerëzore dhe më vëllazërore».

Edhe operatorët kulturorë dhe të mjeteve të komunikimit shoqëror kanë përgjegjësi në fushën e edukimit dhe të formimit, sidomos në shoqëritë bashkëkohore, ku mundësia për të përdorur mjetet e informimit dhe të komunikimit është gjithnjë e më e përhapur. Është detyrë e tyre para së gjithash të vihen në shërbim të së vërtetës dhe jo të interesave

Sa familje, pastaj, mes shumë vështirësive të punës dhe atyre sociale, angazhohen konkretisht për t'i edukuar fëmijët e tyre “kundër-rrjedhës”, duke bërë shumë sakrifica, me vlerat e solidaritetit, të dhembshurisë dhe të vëllazërisë! Sa familje ua hapin zemrat dhe shtëpitë e tyre atyre që kanë nevojë, si refugjatëve dhe emigrantëve! Dua të falënderoj në mënyrë të veçantë të gjithë personat, familjet, famullitë, bashkësitë rregulltare, manastiret dhe shenjtëroret, që i janë përgjigjur menjëherë apelit tim për të mikpritur një familje refugjatësh.

Në fund, do të doja të përmendja të rinjtë që bashkohen për të realizuar projekte solidariteti dhe të gjithë ata që i hapin duart e tyre për të ndihmuar të afërmin në nevojë në qytetin e tyre, në Vendin e tyre dhe në vende të tjera të botës. Dua të falënderoj dhe të nxis të gjithë ata që angazhohen në veprime të tilla, edhe pse nuk u bëhet reklamë: uria dhe etja e tyre për drejtësi do të plotësohet, mëshira e tyre do të bëjë që ata të gjejnë mëshirë dhe, si punëtorë të paqes, do të quhen bij të Hyjit (krh. Mt 5,6-9).

Paqja në shenjë e Jubileut të Mëshirës

Në shpirtin e Jubileut të Mëshirës, secili është i thirrur të njohë se si indiferenca shfaqet në jetën e tij dhe të marrë një angazhim konkret për të ndihmuar në përmirësimin e realitetit ku jeton, duke u nisur prej familjes së vet, prej komshive apo prej mjedisit të punës.

Edhe Shtetet janë të thirrur për të bërë gjeste konkrete, për akte të guximshme ndaj personave më të dobët të shoqërisë së tyre, si të burgosur, emigrantë, të papunë dhe të sëmurë.

Për sa u përket të burgosurve, në shumë raste është urgjente të merren masa konkrete për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës në burgje, duke u kushtuar një vëmendje të veçantë atyre që janë në pritje të dënimit, duke pasur në mendje qëllimin riedukativ të dënimit penal dhe duke vlerësuar mundësinë për të futur në legjislacionet kombëtare dënime alternative në vend të dënimeve me burg. Në këtë kontekst, dëshiroj të përtërij apelin bërë autoriteteve shtetërore për shfuqizimin e dënimit me vdekje, aty ku është ende në fuqi, dhe për të parë mundësinë e një amnistie.

Për sa u përket emigrantëve, do të doja të bëja ftesën për rimendimin e legjislacioneve mbi emigrimin, me qëllim që të gjallërohen prej vullnetit të mikpritjes, në respektimin e detyrave dhe të përgjegjësive të ndërsjella, dhe të lehtësojnë integrimin e emigrantëve. Në këtë perspektivë, një vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet kushteve të jetesës së emigrantëve, duke kujtuar që

klandestiniteti rrezikon t'i çojë ata në kriminalitet.

Po ashtu, dëshiroj, në këtë Vit Jubilar, t'u bëj një apel të ngutshëm përgjegjësve të Shteteve që të bëjnë gjeste konkrete në dobi të vëllazërve dhe të motrave tona që vuajnë për mungesën e punës, të tokës dhe të banesës. Mendoj për krijimin e vendeve të dinjitetshme të punës për t'iu kundërvënë plagës sociale të papunësisë, që ka prekur një numër të madh të familjeve dhe të të rinjve dhe ka pasoja shumë të rënda në mbajtjen e krejt shoqërisë. Mungesa e punës prek shumë rëndë ndjenjën e dinjitetit dhe të shpresës, dhe mund të kompensohet pjesërisht prej ndihmave, të nevojshme, për të papunët dhe familjet e tyre. Një vëmendje e veçantë do të duhej t'u kushtohet grave – për fat të keq ende të diskriminuara në fushën e punës – dhe kategorive të tjera të punëtorëve, kushtet e të cilëve janë të paqëndrueshme apo të rrezikshme dhe pagesat e të cilëve nuk janë të përshtatshme për rëndësinë e misionit të tyre shoqëror.

Në fund, do të doja të ftoja për të bërë veprime të efektshme për përmirësimin e kushteve të jetesës të të sëmurëve, duke u garantuar të gjithëve mundësinë për mjekime dhe për ilaçe të domosdoshme për jetën, përfshirë mundësinë për mjekim në shtëpi.

Duke hedhur shikimin përtej kufijve të tyre, përgjegjësit e Shteteve janë të thirrur edhe për të ripërtërirë marrëdhëniet e tyre me popujt e tjerë, duke u mundësuar të gjithëve një pjesëmarrje efektive dhe përfshirëse në jetën e bashkësisë ndërkombëtare, me qëllim që të realizohet vëllazëria edhe brenda familjes së kombeve.

Në këtë perspektivë, dëshiroj të drejtoj një apel të trefishtë për të mos i tërhequr popujt e tjerë në konflikte apo luftra që shkatërrojnë jo vetëm pasuritë materiale, kulturore dhe sociale, por edhe – dhe për një kohë të gjatë – integritetin moral dhe shpirtëror të tyre; për fshirjen apo mbarështimin e borxhit ndërkombëtar të Shteteve më të varfra; për zbatimin e politikave të bashkëpunimit që, në vend që t'i nënshtrohen diktaturës së disa ideologjive, të respektojnë vlerat e popullatave vendore dhe që, në çdo rast, të mos dëmtojnë të drejtën themelore dhe të patjetërsueshme të fetusit për të ardhur në jetë.

Ia besoj këto reflektime, së bashku me urimet më të mira për vitin e ri, ndërmjetësimin të Marisë shumë të Shenjtë, Nënës që kujdeset për nevojat e njerëzimit, me qëllim që të marrë prej Birit të saj, Princit të Paqes, plotësimin e lutjeve tona dhe bekimin e angazhimit tonë të përditshëm për një botë vëllazërore dhe solidare.

“DIVINI REDEMPTORIS” KUNDËR KOMUNIZMIT ATEIST

**Më 19 mars 1937 u botua enciklika e Piut XI
“Divini Redemptoris” kundër komunizmit ateist**

Enciklika e Papës Piut XI **“Divini Redemptoris”**, botuar më 19 mars 1937, i kushtohet denoncimit e gabimeve të komunizmit ateist. Me këtë Letër enciklikë Papa Piu XI denoncoi gabimet e komunizmit, që “e zhveshi njeriun nga liria e tij duke i dhunuar dinjitetin personit njerëzor e përbuzur çdo vlerë morale, e si pasojë duke udhëhequr shoqërinë drejt humnerës, pa kthim e shpëtim. Për Papën Piun XI komunizmi ateist është “në thelb degjenerues” që ka qëllime të mbrapshta, në të cilat fshehët ideja e “rreme” e shpëtimit dhe përparimit.

Me ‘Mit brennendersorge’, botuar pesë ditë para enciklikës ‘Divini Redemptoris’, Papa Piu XI i jep një goditje të fuqishme dhe denoncon publikisht ideologjitë dhe regjimet totalitare të epokës, komunizmin dhe nazizmin.

Me enciklikat “Divini Redemptoris” e “Mit brennender Sorge” Papa Piut XI dënon totalitarizmat e shekullit të kaluar.

Më 19 mars 1937 Papa Piu XI botonte enciklikën “Divini Redemptoris”, letër që denonconte tmerret dhe krimet e komunizmit. Komunizmi – shkruan Papa – e zhvesh njeriun nga liria e tij, ia zhduk dinjitetin dhe vetëpërmbytjen morale, duke e nxitur me stimuj të verbër. Pak ditë pas këtij dokumenti, e pikërisht më 14 mars, me

“Mit brennenderSorge”, Papa Ratti pati qortuar rëndë sjelljen çnjerëzore të ideologjisë naziste.

Historiani Pietro Skopola flet mbi vlerën e këtyre dy dokumenteve

“Atmosfera është mjaft dramatike, prelud i konfliktit të dytë botëror, ajo që karakterizon publikimin e këtyre dy dokumenteve. Jemi në vigjilje të kësaj ngjarje dramatike, që sundon historinë e shekullit XX e Papa nuk mund të mos i dënonte me shkrim të dy totalitarizmat, dy “fetë shekullare”: nga njëra anë, komunizmin me “Divini Redemptoris”, e nga ana tjetër, nazizmin me “MitbrennenderSorge”. Janë të dyja enciklika të forta; por me atë kundër komunizmit, që është më e prerë, Papa e damkos këtë ideologji çnjerëzore. Dënimi i Papës Piu XI është shumë domethënës e, nga ana tjetër, i paraprin një enciklike tjetër, që nuk u botua, sepse Papa vdiq para se ta shpallte. Është fjala për enciklikën “Humani GenesisUnitas” kundër relativizmit gjerman. Tani ka dalë përsëri në dritë, në sajë të kërtimeve të kohëve të fundit, kur u hapën Arkivat Sekrete të Vatikanit dhe dokumentet mbi papninë e Piut XI, deri pak kohë më parë të panjohura, nisen të shfletohen nga studiuesit. Nga ky studim po zbulohen shumë elemente tepër interesante për historinë e kësaj papnie”.

Çfarë ndikim patën këto dy enciklika?

“Patën ndikim të madh në ato mjedise ku mundën të arrinin, sepse nuk duhet të harrojmë që, si regjimi komunist, apo socializmi real, siç ishte në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe nazizmi, nuk e lejonin lirinë e shtypit, nuk e pranonin qarkullimin e lirë të ideve. Vetë ipeshkvijtë e meshtarët, në homelitë e së dielës, mundoheshin me çdo kusht të mos jepnin lajme që shkaktonin reagime. E nuk duhet të harrojmë se në Rusi, ashtu si në satelitët e saj, njerëzit jetonin në atmosferën e persekutimit fetar. Prandaj mund të themi se ndikimi i të dyja enciklikave u ndje fort në nivelin e klasave drejtuese, që mund të shfrytëzonin çdo lloj lajmi, por në nivelin e masave popullore u njohën pak e aspak, për





shkak të mungesës së lirisë të qarkullimit të ideve”.

Po si t'i kuptojmë këto dy dokumente 46-vjet pas botimit?

“Janë dokumente që ruajnë vlerën e tyre të madhe, sepse denoncojnë fenomenin e fesë shekullare – këtë pretekst të politikës për t'u bërë gjithçka në jetën njerëzore, për të thithur në vetvete edhe përmasën fetare. Dënimi i një ideologjie të tillë pati një vlerë të jashtëzakonshme për kohën kur u bë, por nuk e ka humbur këtë vlerë as sot e mbetet qortim edhe për të ardhmen.

Të dy enciklikat mbeten pikë referimi për vlerat e demokracisë e të lirisë”.

Të dyja enciklikat u botuan njëra pas tjetrës: “Divini Redemptoris” më 14 mars 1937 ndërsa “Mit brennender Sorge” më 19 mars të të njëjtit vit....

“Kemi të bëjmë me një simetri, me dëshirën për simetri, që dënimi i totalitarizmit të së djathtës, nazizmit, të shoqërohej me dënimin e totalitarizmit të së majtës, komunizmit, duke i vënë në të njëjtin plan, si regjime që pretendojnë të thithin gjithçka në politikë, ta bëjnë politikën vlerë absolute, me në

krye një udhëheqës të vetëm, që ka pushtet absolut, si Stalini e Hitleri”.

Çfarë reflektimesh mund të bëjmë sot, gjatë leximit të dy enciklikave?

“Po t'i lexosh sot, të pushton ankthi, kupton sa të tmerrshme qenë tragjeditë e shekullit që lamë pas shpine, në vigjilje të Luftës II botërore, edhe kjo një nga tragjeditë më të mëdha që ka jetuar njerëzimi, gjatë së cilës vdiqën 50 milionë njerëz e linden dy totalitarizma, të cilat mbajnë të njëjtën përgjegjësi për mbytjen e njerëzimit në një det gjaku, në kushte lufte, si nazizmi e edhe në kushte paqeje, si komunizmi. Të dy dokumentet vlejnë edhe për të ardhmen, sepse tregojnë rrugën në të cilën duhet ecur për kapërcimin e mundshëm të pasojave të dy ideologjive kriminale, që nuk janë zhdukur akoma e të ftojnë për rivlerësimin e dinjitetit të njeriut. Temat e tyre u zhvilluan më tej nga Piu XII në mesazhet e tij të famshme gjatë viteve të fundit të luftës, mesazhe që tregojnë qartë se Kisha radhitet haptazi në anën e demokracisë, si regjim i përshtatshëm për garantimin e dinjitetit të njeriut në shoqëri.

Dom Lush Gjergji
Prishtinë

ATENAGORA I – Profet i bashkimit
(1886 – 1972)
(Pjesa e fundit)

Patrik i Konstatinopojës (Stambollit)

Zoti edhe një herë kishte planin e tij me Atenagoren. Por, ja prapë befasia: më 01. XI. 1948 Atenagora u zgjodh Patrik i gjithmbarshëm i Konstatinopojës. Rrethanat ishin vërtet të jashtëzakonshme. Patriku i mëparshëm, Maksimi V, ishte ende i ri, në moshën 52 vjeçare, i zgjedhur vetëm para dy viteve. Mirëpo, gjendja e tij shëndetësore e detyroi për dorëheqje. Pse që zgjedh pikërisht Atenagora? Me siguri se ka shumë arsye, sidomos: për përvojën e tij të madhe baritore, për veprimtarinë e tij të larmishme, për autoritetin të gëzonte veçanërisht në SHBA, si dhe për çështje politike të acaruar në mes të Turqisë dhe Greqisë.

Atenagora I arriti në Konstatinopojë (Stamboll) më 26 janar 1949 me aeroplanin personal të kryetarit Truman dhe që intonizuar një ditë më vonë. Në fjalimin e tij të parë foli qartë „për t’iu dhënë të gjitha

Kishave të krishtera bashkimin dhe paqen, për t’u bërë ato burim i paqes për popujt.“

Atenagora, para së gjithash forcoi bashkëpunimin mes Kishave të ndryshme nacionale ortodokse: organizoi pesë Konferenca gjithëpërfshirëse ortodokse gjatë vitit 1969: ka shkatërruar kundërshtimet që i kundërvinin Konstatinopojën dhe Moskën. Ka bashkuar Ortodoksinë duke bërë primatin e Konstatinopojës jo pushtet juridik për të sunduar apo qortuar, por në stilin e Ungjillit, primat dashurie dhe shërbimi ndaj Kishave simotra.

Në vitin 1950 Atenagora e shpalli enciklikën e parë të gjitha Kishave ortodokse në botë, ku i fton në bashkim të fesë „për ta përgatitur bashkimin e të gjitha Kishave të krishtera në botë“.

Në vitin 1957 filloi takimet e para me Kishën katolike nëpërmes Delegatit Apostolik në Konstatinopojë, Mons. Giacomo Testa-s, që vite me radhë ishte sekretar i posaçëm i Imzot Angelo Roncalli-t, papës së mëvonshëm Gjoni XXIII.

Gjithë jeta dhe veprat e Atenagora I, ishin të udhëhequr nga dashuria ndaj Zotit, Kishës, ndaj njeriut dhe botës bashkëkohore.

Miqësia me papët Gjon XXIII dhe Pali VI

Provania përgatiti edhe një personalitet të madh nga Kisha Katolike, papën Gjoni XXIII, që të kenë mundësi së bashku të punojnë për bashkimin e të gjithë të krishterëve.

Atenagora I, pas shpalljes së Koncilit Dytë të Vatikanit (më 25 janar 1959) tha: “*Bashkimi i të krishterëve është bërë një nevojë aq e qartë, sa që, nëse nuk do të arrihet sa më parë një 'bashkim së paku i kushtëzuar' në mes të tri bashkësive kryesore të krishtera: Kishës katolike romake, protestante dhe ortodokse, Kishës i kanoset rreziku i humbjes së misionit të saj, sepse, nëse s'do të vihet deri te bashkimi, ajo do të humbë shumë besueshmërinë.*”

Kështu filloi bashkëpunimi vëllazëror i këtyre dy krerëve kishtarë në dobi të afrimit ndërkishtarkatoliko-ortodoks, të ekumenizmit të frytshëm me nderim dhe dashuri të ndërsjellë.

Gjoni XXIII lëvizi botën dhe së shpejti vdiq, në pikëllim të të gjithëve. Atenagora I i tronditur tha: “*Sa me gëzim kemi dashur ta vizitojmë*



Romën e ta përqafojmë atë, të qajmë së bashku me të për shkak të përçarjes dhe ndarjes mes nesh gjatë gjithë këtyre shekujve, të tregojmë pendimin tonë për shkak të kaluarës dhe gëzimin për shkak të ardhmes.”

Bashkëpunimi vazhdoi dhe u konkretizua me papën Pali VI. Me rëndësi histori janë tre takimet mes Palit VI dhe Atenagora I: në Jerusalem (5 shkurt 1964), në Konstantinopojë (15 qershor 1967) dhe në Romë (27-28 tetor 1967).

Në Jerusalem mes të tjerash Atenagora I tha: *“Duke shqyrtuar këtë takim si një ngjarje të jashtëzakonshme në historinë dhe në jetën e Kishës së Hyjit, dëshirojmë qëllimet e mira...të bëhen parahyrje e bashkimit të ndërsjellët të vullneteve dhe nënshtrimit i plotë të Vullnetit të Shpirtit Shenjt të Zotit...”*

Me shekuj bota e krishterë jetoi në natën e ndarjes. Sytë e tyre janë të lodhur duke shikuar në errësirë. Dashtë Zoti që ky takim të jetë agim i ditës së lume dhe të bekuar, kur breznitë e ardhshme, duke u ushqyer nga i njëjti kelk i Korpit të Shenjtë dhe i Gjaku të paçmueshëm të Zotërisë, do të lavdërojnë dhe lumturojnë në dashuri, në paqe dhe në bashkim të vetmin Zotëri dhe Shëlbuesin e botës...Ja, duke kërkuar këtë takim të përbashkët ne e kemi gjetur së bashku Zotërinë. Të vazhdojmë, pra, rrugën e shenjtë që hapet para nesh...”

Një nga frytet më të mëdha të këtij takimi dhe përqaimit historik gjithsesi është heqja e mallkimit të ndërsjellët (7 dhjetor 1965) Atenagora duke folur për mallkimin – përjashtimin e vitit 1054, ai ndër të tjera tha: *“Ky gabim në mes Kishës së Romës dhe të Konstantinopojës, duke imituar dashurinë dhe mirësinë e Zotit ndaj njeriut, na detyron për këtë arsye në rikthimin e paqes...”*

Me rëndësi historike, ishte edhe vizita e papës Pali VI Konstantinopojës, i cili në Katedralen e Fanarit, ku ndër të tjera pati thënë: *„Ne përkujtojmë këtu katër koncilet e mëdha ekumenike në Nice, në Konstantinopojë, në Efez dhe në Kalcedoni, që etërit kishtarë s'kanë pasur frikë t'i krahasojnë me katër Ungjijtë...”*

Në fjalën e rastit Patriku Atenagora I ndër të tjera iu përgjigj Papës kështu: *“Shenjtëri dhe i dashuri vëlla në Krishtin. Duke dëshiruar mirëardhje, fortë i shenjtë pasardhës i Pjetrit, që e bartni emrin dhe keni sjelljen e Palit, kasnec i dashurisë, bashkimit dhe paqes...Ne përshëndesim ardhjen Tuaj në Lindjen tonë si një agim të ri të dritës së ndriçuar nga Zotëria, në historinë e dy Kishave tona, të Romës dhe të Konsantinopojës, të botës ortodokse dhe katolike, të gjithë besimtarëve dhe të botës mbarë. Mirë se vjen, Vëlla, në emër të Zotit!”*

Në takimin e tretë mes Atenarorës I dhe Palit VI në Romë iu dha ekumenizmit një nxitje dhe

inkurajim. Me atë rast Patriku Atenagora mbajti fjalën e rastit para kardinajve dhe anëtarëve të Sinodit ipeshkvor, ku ndër të tjera tha: *“Ne mendojmë kah çasti i madh dhe i shenjtë, kur ipeshkvijtë e Perëndimit dhe të Lindjes do të bashkëmeshojnë në të njëjtin lter, duke ngritur kelkun e Zotërisë nga Eukaristia e përbashkët.”*

Trashëgimia e tij shpirtërore

I madhi, mund të themi edhe i shenjtë, Patriarku ekumenik Atenagora I, vdiq më 7 korrik 1972, pas tetë ditë sëmundjeje. Vdekja e tij, ishte humbje e madhe, jo vetëm për Kishën ortodokse, por edhe për mbarë krishterimin, do të thosha edhe për tërë njerëzimin.

Me 9 korrik Papa Pali VI duke iu folur besimtarëve në Sheshin e Shën Pjetrit, tha: *“Ju e dini, pse Ne e përkujtojmë këtë njeri të madh të Kishës së nderuar, por ende jo tërësisht të bashkuar me Kishën Katolike; e porosisim në kujtime dhe uratë tuaja: sepse ai ishte mjeshtri i gjithëanshëm dhe apostull i bashkimit të Kishës greko-ortodokse me atë të Romës, si dhe Kishat dhe bashkësitë tjera të krishtera, ende të pabashkuar në të vetmin bashkim të Korpit mistik të Krishtit. Ai e ka pasur vetëm një shpresë të lartë: atë që të mund të pinte së bashku me Ne “nga i njëjti kelk”. Kjo dëshirë e pazbatuar duhet të jetë trashëgimia e tij dhe kujdesi ynë”.*

Atenagora I ishte pikësëpari njeri i Zotit, njeri i Kishës, ekumenizmit, lëvizës i madh i bashkimit të krishterëve. Shpeshherë thoshte; *„Zoti është afër nesh dhe me Të edhe njerëz janë të afërt. Nëpërmes Krishtit ne kemi zbuluar se Zoti është Dashuri.”*

Duke menduar mbi ndarjen e Kishave dhe të krishterëve me zemërim në zemër komento: *„Çka kemi bërë ne? Çka kemi bërë? Krishti ka hequr dorë prej nesh. Ne e kemi dëbuar atë. Me armiqtë tona, me krenarinë tonë, me paturpësinë tonë farizeje, ne kemi fyer shpirtin e Ungjillit... Krishti është larguar... Ku do të ketë shkuar?... Shkon si shtegtar, si i panjohur në mesin e të varfërve, të braktisurve e të lënëve të këtij vendi. Ku do mund të ishte? Ndoshta në Indi, apo Afrikë? Apo në lagjet e mjerueshme të qyteteve të mëdha? Mirëpo, ne nuk mund të jetojmë pa Të, nuk mundim. Duhet ta gjejmë atë...Unë nuk merrem me politikë. Ajo s'më intereson... Mua më intereson Krishti dhe Kisha e tij, bashkimi i Kishës në paqe e dashuri. Dialogu do të sqaronte shumë pyetje...Ne të krishterët duhet palodhshëm të kërkojmë bashkimin e Kishave simotra dhe vëllazërimin e popujve.”*

Atenagora I, ishte dhe mbeti jetë, porosi, dëshmi të cilën ia vlen ta zbulojmë. Dhe trashëgimi të cilën duhet ndjekur, jetuar sot e në të ardhmen.

Don Nosh GJOLAJ
Podgoricë

KULTIVIMI I SINQERITETIT (Pjesa e parë)

1. Armiku i sinqeritetit është gënjeshtria

Zakonisht fëmija nga frika apo nga frustrimi fillon të gënjejë dhe nuk është i sinqertë. Gënjeshtria nuk është asgjë tjetër përveçse një arsyetim qoftë nga frika qoftë nga refleksi mbrojtës. Zanafilla e gënjeshtres fillon në moshën e njomë siç thamë më lartë te fëmija, në atë gjirin familjarë në të cilën nuk mbretëron harmonia, besimi, mirëkuptimi ndërsjellët, por fatkeqësisht dora e çeliktë qoftë e nënës apo e babës ose dikujt tjetër. Nga frika e ndëshkimit që mund të pasoi njeriu i ri, si bie fjala nuk i ka kryer detyrat, obligimet, apo e ka thyer ose shkelë ligjin, urdhrin apo diçka tjetër. Kuptohet edukata me frymën e frikës e formon njeriun në dy binare të jetës, siç themi ndryshe njeriun me dy fytyra. Njeriu i formuar me dy fytyra është jo vetëm gënjeshtër që ndoshta i beson edhe vetvetes nga rrena që ai e thure por është edhe mjeshtër i shkathtë për te ju shmangur detyrave, obligimeve, përgjegjësi etj.

Çifti martesor kishte dashur të shkundet nga dyfytyrësia, nga mendësia “bizantine” që një flet, tjetri mendon e një tjetër e bënë. Po qe se partnerët apo të dashruarit ia shtrojnë vetes pyetjen: “Pse të frikësohesh nga sinqeriteti?” Sepse herët apo vonë gënjeshtria del në shesh, siç thotë ajo fjala e popullit: “Rrena i ka këmbët e shkurtra!” Po qe se partnerët hyjnë në bashkësinë e martesës të ngarkuar e të frustruar e po ashtu frikësohen mos t’ia zbulon ai tjetri të metat apo mungesat. Vetvetiu kuptohet, një qëndrim i tillë jo vetëm se e dëmton tjetrin edhe veten por është vetëm një situatë e pakuptueshme! Sepse qëndrimet e tilla nuk krijojnë e as nuk e zhvillojnë dashurinë, fisnikërinë, fatlumturin por në të kundërtën është ai krimbi që dalëngadalë e shkatërron, e asgjëson, e zbe, jo vetëm individin që do të bëhet skizofrenik por edhe bashkësinë e fatlumturin e kopshtit martesor. Çifti duhet gjithherë e kurdoherë të kenë parasysh korrigjimin, formimin e individit të sinqertë duke i mposhtur çdo ditë paragjykimet, ngarkimet, frustrimet, friken etj. Në të kundërtën do të na shoqëroi si ajo hija e zezë gënjeshtria, mashtrimi, jo sinqeriteti, hipokrizia, fariseizmi, dashje apo pa dashje na behën shprehi të cilat nuk do t’i mund t’i asgjësojmë deri në vdekje, sepse kalojnë që nga sfera e

vetëdijes në sferën e nënvetëdijes tonë.

Partnerët e dashruar duhet gjithmonë të tentojnë për një sinqeritet të përhershëm, sepse sinqeriteti është ilaçi më i mirë për ta ruajtur dashurinë afatgjatë, fatlumturin dhe harmoninë në mes tyre. Me një fjalë tjetër sinqeriteti është parakusht për bashkësinë martesore e për kultivimin e kopshtit të dashurisë. Po qe se në të vërtetë e do personin me të cilin je i dashuruar dhe kjo dashuri është e dyanshme atëherë është e kuptueshme edhe besnikëria që do t’i besosh dhe do të beson, kështu fillohet të kultivohet sinqeriteti. Po ashtu është mjaft i rëndësishëm edhe kujdesi i mirëfilltë ndaj dashnorit apo dashnores, që fillon



me “abc..” apo siç themi shqip me rregullat e mirësjelljes, duke i frenuar fjalët fyese, të cilat lëndojnë jo vetëm personin e dashur por edhe dashurinë e cila është mjaft e ndjeshme, gjithashtu edhe sjellja e jonë ndaj tjetrit duhet të jetë e ndjeshme, fisnike, korrekte, kuptohet gjithherë e sinqertë. Këshillohen gjithmonë jo vetëm partnerët e martesës por çdo individ t’i peshojnë mirë fjalë përpara se do t’i artikulojnë, po ashtu nuk është mirë të flitet posaçërisht mos të vendoset gjatë emocioneve qofshin ato nga urrejtja, hidhërimi qofshin ato nga gëzimi, sidoqoftë çdo vendim nën

ndikimin e emocioneve do të jetë i gabuar, e në fund jo vetëm se e kemi mashtruar veten por edhe tjetrin. Po ashtu nuk bënë kurrë të flasim thashethemet, apo nën prizmin e paragjyimit, në veçanti për të metat apo dobësitë e tjetrit përkatësisht këtu për metat e partnerit apo të dashnorit (dashnores). Çdoherë e kurdoherë partneri jo vetëm se e ka për detyrë apo borxh por edhe kujdesin e përhershëm për t'i verifikuar pohimin apo mohimin, ose sjelljen, veprimin etj. Në të kundërtën shumë lehtë çifti martesor mund të bien nën ndikimin e politikës së ditës, që nuk është asgjë tjetër përveç një sjellje e papjekur mos të themi një sjellje e fëmijës, i cili ende nuk e ka identitetin e formuar, sot kështu e nesër ashtu. Siç shprehet populli: "Ja kthen shpinën si ç'fryn era!" Zakonisht njerëzit apo tipi i tillë është mjaft luhatshëm, nuk e ka të formuar uni (egon), identitetin qoftë atë kombëtar, fetar, etiko-moral, e me një fjalë janë gjithëherë plaçkë e lehtë e politikës ditore, ideologjisë, apo i okupatorit ose armikut. Sepse tipi i tillë është puthadorë!

Në jetën e përditshme takojmë edhe tipin e njeriut, i cili pa ngrysim fillon menjëherë të çelet dhe thajse flet jo vetëm në mënyrë spontane apo të natyrshme por pa paragjykime për veten e vet, për emocionet, për të kaluarën, për gabimet dhe metat ose dobësitë që i bartë me vete. Thajse ata flasin me një farë kënaqësie e krenarie. Por në fillim të bënë përshtypje dhe e japin një pamje të një njeriut guximtar, tipit normal por në rastet e shumta është njeriu i sëmure psikik, posaçërisht eksponohet tipi mazohist, i cili e akuzon, e fajëson vetveten e ka një farë kënaqësie kur përjeton dhunimin, poshtërimin, shkeljen, nënshtrimin nga ana e tjetrit. Sepse ata ashtu e realizojnë veten, atë pjesë që u mungon, identitetin, lirinë, përgjegjësinë, pavarësinë. Sepse ai nuk ka as lirinë, as pavarësinë, as unin e vet por realizohet apo aktualizohet përmes tjetrit, i cili ia mohon të gjitha çka e theksume më lartë. Zakonisht tipi i tillë jo vetëm se është i bezdisshëm, apatik, i mërzitshëm por krijon edhe huti e pasiguri në gjirin martesor, që e çoroditë kopshtin e dashurisë.

Ndërsa tipi i kundërt është introvert krejtësisht i mbyllur i tërhequr në vetvete, i ngurtë. Zakonisht ka vështirësi jo vetëm t'i shprehin mendimin por edhe t'i artikulojnë fjalët. Ata nuk flasin fare mbi veten, për të kaluarën as për të metat apo virtytet që i kanë ose talentin, po ashtu nuk i shprehin nevojat, kërkesat, dëshirat por rrinë e vuajnë në vetvete. Pothuajse me pince duhet t'iu nxjerr çdo fjalë, siç është ajo shprehja popullore: "fol se po t'i jap tre grosh!" Për të depërtuar në thellësinë apo në brendësinë e tij nuk është lehtë, kërkon durim dhe

kohë nga ana e partnerit. Zakonisht tipi i tillë e bartë me vete atë hijen e frikës që nga mosha e njomë e fëmijërisë, i cili e ka përjetuar ndonjë lëndimin serioz, qoftë nga ana e prindit, apo nga gjiri familjar ose nga shkolla apo mjedisi, që ia kanë lënë vulën e pashlyeshëm mosbesimit ndaj tjetrit, i cili mbyllet në bunkerin e padepërtueshëm. Por mund të jetë edhe diçka tjetër: atje ku është egoja "uni" i dobët ose nevoja për pushtet, atëherë aty është e ngjyrosur dhe i theksuar pushteti në mënyrë perfide, që di tipi tiran ta shprehin ndaj tjetrit. Dhe nuk është asgjë tjetër përveç impulsi apo dëshirat për ta mposhtur tjetrin, në këtë rast partnerin apo dashnorin (dashnoren).

Të kërkosht sinqeritetin nga tipi i tillë është njësoj si të kërkosht ujë nga shkretëtira e thatë, në të cilën vend nuk ka burim as nën tokësor as mbi tokësor! Po qe se ecet kësaj rruge, ajo do të çoj vetëm kah ngarkesa dhe frustrimet por edhe kah çrregullimi i kopshtit martesor!

Partnerët të cilët nuk kanë probleme as nuk janë të ngarkuar sa i përket sinqeritetit, ata duhet edhe më tutje gjatë rrugës së përbashkët ta kultivojnë sinqeritetin. Sepse lehtë mund të infiltrohet gjatë kësaj rrugë refleksi mbrojtës, apo kundërsulmi, që e shpie çiftin në udhën e pa kthim. Për ndryshe arma më efikase kundra gënjeshtres apo dyfytirësi është mirësjellja, fjalori apo shprehitë e mirëfillta, sinqeriteti në të cilën jo vetëm se përjeton kënaqësi por e kultivon fatlumturin e ashtu i zgjatet jeta e dashurisë, që me siguri kopshti martesor jo vetëm se lulëzon e jep frytin e duhur por i jep aromën apo kulturën, qytetërimin civilizimin e ngritjen në sferën e lartë njerëzore jo vetëm vetes apo individit si të tillë por edhe rrethin apo mjedisit në të cilin jeton e vepron.

Po qe se në mesin e partnerëve gjendet tipi i çelur, i cili pa ndërpre e padit, e fajëson vetveten, pothuajse se e tepron a bëhet i bezdisshëm e i mërzitshëm, jo vetëm se ai ka një farë kënaqësie që nuk është asgjë tjetër por sjellje perverse mazoiste, që jo vetëm e ngarkon kopshtin martesor por atë edhe e shkatërron, tipit tillë duhet t'i ndihmohet për ta krijuar identitetin, për ta formuar dhe për ta çmuar lirinë, pavarësinë, njëherazi, dhe për ti dhënë kurajën që të dalin jashtë rrethit pervers në freskinë e lirisë, të pavarësisë, duke i gjetur ato pikat e mira, talentin, aftësitë për t'i shti në veprim. Menjë fjalë për ta aktualizuar apo realizuar vetveten të pacenuar, kuptohet duke korrigjuar veten apo shprehitë e dobëta, e duke eliminuar dobësitë e duke fisnikëruar e duke i ngritë shprehitë e mira dhe

talentin. Është me rëndësi vetëdijesimi i plotë ndaj vetvetes që të mund të korrigjohesh në ata që dëmton jo vetëm unin, veten por edhe tjetrin afër tij.

Nuk duhet të harrohet se edhe sinqeriteti i ka kufijtë e vet. Nëse me qëllim ose pa qëllim gjithherë fyhet, poshtërohet, merret neper këmbë partneri tjetër, aty sigurisht jo vetëm se nuk mund të kultivohet sinqeriteti por krijohet huti, frik, pasiguri nga tirani i sëmure apo autokrati i pagdhendur.

Disa psikolog u propozojnë kandidatëve për martesë po ashtu edhe çiftit martesor, të njihen edhe me shkencat e psikologjisë në veçanti me “psikologjinë e thellësive” posaçërisht atë të ëndrrave. Si fjala vjen, njëri prej partnerëve gjatë mëngjesit të përbashkët e tregon ëndrrën e natës, e cila sigurisht e ka një porosi që dëshiron t’ia japin partnerit. Por duhet me kujdes e me durim të dëgjohet deri në fund e mos të lëndohet i dashuri apo e dashura nga sjellja e jote arrogante apo indiferente ose tallëse që reagon si bie fjala në këtë rast ndaj ëndërrues. Jo vetëm se lëndohet partneri në fjalë por edhe shqetësohet ngarkohet e mos të themi frustrohet edhe më tepër që shkakton pakënaqësi edhe mos të themi huti!

Kemi edhe raste të shumta që partnerët e përdorin jo sinqeritetin në format e ndryshme, siç thuhet në mes gazetës së mëngjesit dhe të sandviçit përdorë fjalorin ironik e tallës siç bie fjala në shembullin që vijon për mos ta shqetësuar, partneri apo partnerja ia shpreh në formë të ëndërrës sinqeritetin siç bie fjala: "Isha i dehur pas një gruaje, e cila ishte e bukur e mahnitëse. Mendoj me vete si t’ia kthej vëmendjen asaj dhe njëherë mos të vërej bashkëshortja?" Në këtë rast shprehet sinqeriteti në mënyrë tërthorazi, por sinqeriteti siç e thamë më lartë i ka kufijtë, e në këtë rast nuk është asgjë tjetër përveç mungesa e kulturës, e bontonit, e në mënyrë ironike shprehet brutaliteti apo arroganca ndaj tjetrit. Bie fjala, dyzetvjeçar (40), i cili është i martuar e ka një traditë në jetën e përbashkët në martesë. E po qe se sjelle në mënyrë jo të sinqertë e ironike, diçka në bashkësinë apo në kopshtin martesor nuk është në rregull. Sepse ata gjatë jetës së përbashkët për sa e sa vitet, ata kanë pasur mjaft mundësi për t’u njohur, për t’u çelur po ashtu s’bashkuat me lëvizjet e vogla apo hap pas hapit për t’ia arrit pjekurinë e sinqeritetin e të plotë. Asnjë farë moshe as periudhe nuk mund të kërkojë nga ai tjetri princin apo princeshën, njeriun apo individin e përsosur, por gatishmërinë për t’u përshtatë, për t’u korrigjuar e për t’u fisnikëruar që

është sinqeriteti më se i mirëseardhur. Po ashtu duhet të mposhten principet të njërit apo të tjetrës palë, po ashtu edhe mizat, teket sepse të gjitha këto e shpien kopshtin martesor në ujin e turbulluar dhe të pa sinqeritetit dhe të gënjeshtres apo të mashtrimit.

Vetëkritika e vet verifikimi i çdo pohimit apo mohimit të individit normal që e përdor arsyen e mendjes së shëndoshë është e domosdoshme. Ai gjithherë nuk i frikësohet sinqeritetit por edhe njëherë i shërben jo vetes por edhe tjetrit që mundohet gjithherë në çdo rrethanë apo mjedisi për t’i gjetur pikat e përbashkëta ose emërtuesin e përbashkët. Gjithherë me kujdes e durim për t’i pëlqyer tjetrit. Kuptohen sjelljet e tilla jo vetëm se janë të mirëseardhura po ato e shkrijnë akullin e krijuar e ndërtojnë më tutje dashurinë, fisnikërinë e fatlumturin e përbashkët. Por kopshti martesor do gjithherë kurdoherë jo vetëm të jesh vigjilent por edhe punëtorë për ta punuar e për ta kultivuar. Arma më e sigurt është sinqeriteti.

2. Mospërputhja mes dashurisë edhe egoizmit

Para se të fillojmë ta paraqesim këndvështrimin psikologjik të dashurisë është mirë ta pastrojmë mendimin apo nocionin e gabuar të egoizmit, siç bie fjala dashuria ndaj vetvetes e ndaj tjetrit përjashtohen, apo e përjashtojnë njëra tjetrën. Po qe se është virtyt ta duash të afërmin si qenie njerëzore atëherë është edhe virtyt ta duash edhe veten, sepse edhe unë jam qenie njerëzore. Nuk njohim ndonjë koncept mbi njeriun, që nuk do të ndërlihet me të. Çfarëdo mësimi i cili e përjashton unin tim apo veten time ose njeriun është i gabueshëm dhe mashtrim. Pikëpamja biblike: “duaje tjetrin si vetveten” do të thotë respekt te plotë ndaj vetvetes, ndaj dashurisë e ndaj kuptimit që e kemi po ashtu ndaj vetes e nuk mund të jetë në kundërshtim me dashurinë e kuptimin e shëndoshë ndaj njeriut tjetër si qenie njerëzore.

Sa i përket psikologjisë së dashurisë, zakonisht mund të themi, nuk është ai tjetri objekt por edhe ne jemi objekte të dashurisë, emocioneve, ndjenjave e qëndrimit, jo vetëm qëndrimi i shëndoshë ndaj tjetrit por edhe ndaj vetvetes, që nuk është asgjë tjetër përveç plotësimi i vetvetes në ata që më mungon mua, e ai tjetri e posedon, kuptohet në mënyrë reciproke apo ndërsjellët. Që do të thotë dashuria e vërtetë ndaj vetes është e rëndësishme jo

vetëm për individin por edhe për njeriun, i cili di të dashurohet në tjetrin. Dashuria e vërtetë nuk mund të ndahet mes neve dhe objektit. Sepse dashuria e vërtetë është veprim i zemrës, respektit, përgjegjësisë e mendjes së shëndoshë. Nuk është fjala për emocionet apo pasionin e impulsit seksual, që dikush atë e do, por angazhimi dhe orvatja, rritja apo zhvillimi që shpie në fatlumturi, kështu të dashuruarave u sjellë jo vetëm aftësi për tu dashuruar por edhe për ta krijuar fatlumturin afatgjatë.



Ta duash dikë është jo vetëm fjalë por edhe përqendrimi i njeriut i aftësive të tij për dashuri. Te dashuria zakonisht është në rendin e parë nxitja që na shtynë ta duam personin tjetër, kuptohet të gjinisë së kundërt, që i ka cilësitë njerëzore. Dashuria ndaj personit tjetër nuk është asgjë tjetër përveç dashuria ndaj njeriut.

Dashuria ndaj njeriut apo personit tjetër, zakonisht nuk është mendimi abstrakt, që arrihet përmes dashurisë deri te personi konkret, por aftësia që e pranojmë ashtu të trashëguar nga parët tanë, që jemi njerëz të aftë për të dashuruar e me qenë të dashuruar.

Qëllimi i jetës, i fatit, zhvillimi e liria e kanë themelin në aftësitë e dashurisë, në zemrën e njeriut, në respektin ndaj tij, në përgjegjësinë e mirëkuptimit e përbashkët. Po qe se individ i është i aftë për dashurinë e vërtetë ndaj tjetrit apo ndaj të afërmit atëherë është njëherë edhe i aftë për ta dashur vetveten me atë dashurinë e vërtetë; po qe se aftësia e njeriut mbetet vetëm për ta dashur atë tjetrin, atëherë dashuria e tij nuk është e plotë.

Meqë dashuria ndaj vetes nuk është e shkëputur nga dashuria ndaj tjetrit, atëherë si ta shpjegojmë egoizmin vetjak, që e përjashton raportin e drejtë ndaj të afërmit? Egoisti interesohet vetëm për vete, gjithçka do për vete, ai nuk ka kënaqësi në dhuratën që dhuron, por vetëm për ta marrë. Në aspektin e jashtëm është njeriu i pangopur me sytë e uritur për të pronësuar. Nuk ka prirje për nevojat e tjetrit, për këtë as nuk i pranon si vlera njerëzore të tërësishme e mos të themi nuk ka fare respekt ndaj tyre. Përpos vetes nuk mund ta


shohin tjetrin, për këtë çdo gjë po ashtu edhe njeriun ai e çmon apo e vlerëson sa ka dobi prej tij. Në substancë apo në themel ai nuk ka aftësi për dashurinë e vërtetë. Ai përjeton, se dashuria ndaj të afërmit e ndaj vetes janë si dy alternativa pa të cilat nuk mundet, si të ishin dashuria ndaj afërmit e egoizmi në të njëjtë vijë. Vetvetiu kuptohet se një bindje e tillë nuk është vetëm mashtrim apo gënjeshtëri, që ka shkatërruar sa e sa martesë e mos të flasim mbi ferrin apo kanibalizmin e shkakuar në kopshtin martesor por pikërisht nga kjo pikëpamje apo mendësi burojnë të gjitha të zezat që ia sjellë vetes dhe tjetrit. Egoizmi dhe dashuria ndaj tjetrit nuk janë të njëjtat gjë por ato janë diametral të kundërta dhe e përjashtojnë njëra tjetrën. Egoizmi vetjak nuk e do as vetveten fare, mos të themi, ai e urren veten. Mungesa e dashurisë ndaj vetes, që nuk është asgjë tjetër përveç mungesa e aftësisë për t'u dhuruar, e lëshon individin të zbrazët, të vetmuar e pa baraspeshë ndaj jetës së përditshme. Fjala është për individin e falimentuar që jeton në ankth, në frik, që nuk ka aftësi për ta dashur veten. Shihet se më shumë merret me veten, që nuk është asgjë tjetër përveçse kërkesa e pangopur për ta plotësuar mungesën e dashurisë ndaj vetes. Sipas Freudit, egoisti është i ngjashëm me narcisin, i cili koncentrohet në vetë dashurinë ndaj vetes. E vërtetë është se egoisti është i paaftë për dashurinë ndaj tjetrit e njëherë i paaftë për ta dashuruar edhe vete. Për këtë është mjaft e rëndësishme për çiftin martesor apo për të dashuruarit ta verifikojnë këtë pohimin e ErichFromm-it që është i përshtatshëm në "Artin e dashurisë". Këtë e kërkon sinjeriteti i mirëfilltë.

SQAROHET ORIGJINA E GJON BUZUKUT ISHTE NGA MJEDA

Jaho Brahaj - "Kronikë e Derës së Gjon Buzukut" Tiranë (2005).

Cila është origjina e Gjon Buzukut? Ku i pat rrënjët familja e autorit të së parës vepër në shqipe? Në librin "Kronikë e Derës së Gjon Buzukut" e botuar nga studiuesi JahoBrahaj (2005) hidhet dritë mbi historinë e familjes nga rridhte autori i monumentit të gjuhës shqipe, "Mesharit". Meqenëse deri vonë ka pasur pak të dhëna për prejardhjen e tij familjare dhe është diskutuar shumë për këtë çështje, e po ashtu meqenëse më së shumti studiuesit janë fokusuar te gjuha e tij, po botojmë një fragment nga libri i Brahajt.

Në kapitullin "Skemë gjenealogjike e derës së Gjon Buzukut", ai shkruan se "Gjon Dedë (Bdek) Buzuku është pasardhës i familjes së njohur Renësi-Buzuku, derë e njohur në mesjetën shqiptare. Selinë kjo derë e lashtë e kishte në fshatin Renësi (Ranasi) të Mjedës, sot i zhdukur nga përmytjet dhe nga prurjet shekullore të lumit të Drinit dhe Gjadrit, fshat i afërt me Mjedën dhe me Danjën e famshme e në krahun tjetër Vigun, në kufi me Hajmelin". Sipas Brahajt, Renësi ishte fshat i dyzuar me Renësin e Shëngjinit, ku kjo derë kishte prona dhe qytezën sipër portit, aty ku sot është fshati Mali i Renësit. "Pasardhësit e familjes Renësi, të cilët mbajnë dhe



mbiemrin Buzuku (Buziko, në dok. e gjuhës italiane), luajtën një rol me rëndësi në veprimtarinë në të mirë të çlirimit të atdheut nga pushtuesi turk", vëren autori në studimin e tij. Ai shton se ata (pra familja Buzuku), sipas interesave të Shqipërisë, në fillim përkrahën e i shërbyen Napolit, sa ishte në aleancë me Skënderbeun. "Kur Venediku përkrah Skënderbeun e Ri, në ekspeditën për çlirimin e Shqipërisë, ata ikën pa leje nga Napoli dhe u vunë në shërbim të Skënderbeut të Ri e të Venedikut. Po kështu Renësi-Buzukët, i shohim në shërbim të Mbretit të Spanjës, kur ky e shpalli veten si mbrojtës i interesave të popullsisë së pushtuar nga Turqia", bën me dije JahoBrahaj. Studiuesi thotë se, Buzukët gjithmonë kanë ngelur në shpirtin e tyre shqiptar dhe shembull për këtë është ndihma e tyre financiare, që kurorëzoi punën e palodhur të njërit prej tyre, Gjonit të Dedë Buzukut, me përkthimin e botimin e "Mesharit".

Në hulumtimet për derën, që nxori Gjon Dedë Buzukun, rezultojnë edhe të dhëna, që flasin për historinë mesjetare të paraardhësve të Renësi-Buzukëve, Buzëzezët, derë shqiptare shumë e njohur, me fillime të njohura që në shek. XI.

Gjenealogjia

Më poshtë, nga libri i Brahajt kemi shkëputur fragmentin, "Skemë gjenealogjike e Derës së Gjon Buzikut", që po e botojmë të plotë pa ndërhyrjen tonë: Nga radha e pjesëtarëve të derës Buzuku (Buzikio, Buzukio) krahas shumë personaliteteve që kanë se çfarë t'i thonë historisë së kombit tonë, kemi dhe këto të dhëna. Në vitin 1474, në dokumentet për stratiotët e kësaj dere njihemi me Pjetër Buzukin. Po ky person, në vitin 1484, më 21 maj, pasqyrohet; Pjetër Renës.

Në vitin 1482, po në dokumentet arkivore veneciane kemi një informacion të zgjeruar rreth pjesëtarëve të kësaj familjeje, që është rebeluar në More (Greqi). Njihemi që Meksa Buziki është vëlla i Pjetrit dhe i Dumës. Pra kemi tre vëllezër.

Në vitin 1493, Leka (Lecha) Renësi, është fitues i provizionit nga ana e Venedikut, sepse i është vrarë babai, Pjetër Renësi-Buziku. Provizionin e përfiton bashkë me nënën (gruan e Pjetrit) dhe tri motrat e tija (bijat e Pjetrit). Kjo datë është edhe njoftuesja, që Pjetër Buziku ka vdekur në luftime.

Në vitin 1498, bijtë e po këtij Pjetri: Leka, Deda (Dominiki), dhe Progoni përfitojnë një provizion vjetor me pagesë në katër këste vjetore, por me detyrimin, që të mbajnë secili nga një kalë të mirë për t'i shërbyer Sinjorisë (Venedikut). Ky dokument na njeh që Pjetër Buziku, i cili siç e dimë, ka vdekur para vitit 1493, ka lënë tre djem dhe tri vajza. Këtu kemi një veçori me pasqyrimin e pasardhësve të Pjetrit. Si e pamë në dok. e vitit 1493, Leka jetim përmendet me nënën dhe tri motrat, kurse në vitin 1498, përmenden edhe dy vëllezërit e tjerë të Lekës (bij të Pjetrit), Deda dhe Progoni. Këta të tre, tani deri sa detyrohen të mbajnë nga një kalë për t'i shërbyer Sinjorisë, janë në moshën mbi 21 vjeçare. Atëherë, Leka, në vitin 1493, duhet të këtë qenë i vogël, (nën moshën 17 vjeç), deri sa në këtë vit përfiton provizion, ndërsa dy vëllezërit e tjerë duhet të kenë qenë mbi moshën 18-vjeçare. Duma në ditët e fundit ka jetuar në Kandia (Kretë) dhe po këtu jeton i biri Nikolla.

Më 4 mars 1510 marrim vesh se ka vdekur

Dedë Buziku dhe kryesimin e kompanisë së kalorisë e merr Gjergj Buzuku, nipi i tij. Me datën 8 të këtij muaji njihemi se fëmijëve të tij (të Dedës) nga Venediku ju jepet provizioni. Këtu në këtë dokument nuk na jepet emri i djalit të tij, por saktësohet provizioni që jepet për bijat, që janë tri. E madhja është Angjelina, (Angelina), që do përfitojë më shumë, si duket nga që është në moshën e martesës.

Motrat e vogla janë Dukja, (Duchina), dhe Lukja, (Luka). Mungesa e informacionit për birin e Dedës (Dominiki), që nuk ja njohim as emrin, është një boshllëk dokumentacioni, por edhe nëqoftëse dokumenti do na jepte emrin e tij, ai do na zbulonte

vetëm si e kishte emrin, para se të dorëzohej në gjirin e urdhërit fetar, sepse dimë që në këtë rast emri ndërrohej dhe Gjoni, autori i Mesharit nuk ka pasur këtë emër në pagëzimin e tij. Duke u nisur nga të dhënat e mësipërme, moshë e tij duhet të këtë qenë e një fëmije të njomë në vitin e vrasjes së babait. Vdekja e babait të Gjunit, Dedës, është e vitit 1510, ai duhet të ishte afërsisht 10-vjeçar. Në dokument nuk përmendet as nëna e tij. Për pasardhësit e Meksës nuk kemi të dhëna.

Duma, vëllai tjetër, ka djalë Nikollën dhe Gjergjin dhe kemi informacion se ky i pari

ka një vajzë. Edhe për Dumën njihemi që ka vdekur, (është vrarë), në vitin 1498 në Kretë. Djallë tjetër të tij Gjergjit i jepet: "...kryesia e njëzetekatër kalorësve që deri tani i kishte i ndjeri (Domenik) Dedë Buziku, xhaxhai i tij...". Këtë Gjergjin, në vitin 1528, e shohim të jetë kapedan kalorësie në Pulje. Deri këtu kemi këtë skemë të gjenealogjisë së Gjon Buzikut: Meksë - Pjetri - Duma janë vëllezër.

1) Për Meksën nuk kemi të dhëna për pasardhësit.

2) Pjetri ka tre djem: Lekën, Dedën dhe Progonin dhe tri vajza, të cilave nuk ua dimë emrat.

3) Deda, i biri i Pjetrit, ka tri vajza me emrat Angjelina, Dukja dhe Lukja që janë motra të Gjunit, autorit të Mesharit.

4) Duma dimë se ka dy djem; Nikollën dhe Gjergjin.

Fatmira Nikolli



Admirina PEÇI

Tiranë

PSE MJEDA NUK U DËNUA NJËSOJ SI FISHTA NGA REGJIMI KOMUNIST

(Pjesa e parë)

Konferenca e tretë e Lidhjes së Shkrimtarëve e vitit 1949 do të trajtonte imtësisht gjithë historinë e letërsisë shqipe nga fillesat e saj deri në atë kohë. Mes tezave që përgatiteshin për tu mbajtur në këtë konferencë në prill-maj të 1949-ës është edhe një studim i përgatitur nga Gjovalin Luka për Historinë e letërsisë shqipe nga fillesat deri në vitet e para të realizmit socialist.


Një dosje voluminoze me materiale të kësaj konference ruhet në AQSH dhe lexuesi ynë është njohur me një pjesë të këtyre materialeve nga botimet tona të muajve të fundit. Materiali i fundit që u botua nga kjo dosje ishte ai mbi Gjergj Fishtën, analizën e veprës së tij dhe arsyet pse regjimi komunist e dënonte dhe e quante atë vepër “shoviniste”.

Në vijim të botimit të këtyre dokumenteve sjellim sot dhe për ta vijuar edhe në numrin vijues një material kushtuar autorit Ndre Mjeda dhe veprës së tij. Si e shihte regjimi komunist këtë autor? Pse Mjeda, edhe si një prej autorëve katolik të Shkodrës nuk u pa me të njëjtën lupë sikurse Fishta? Analiza e më poshtme

zbardh shumë pikpyetje mbi raportet e regjimit me këtë autor të shquar të letërsisë shqipe. Më poshtë sjellim pjesën e parë të studimit mbi Mjedën përgatitur si një prej tezave që do të diskutoheshin në konferencën e III-të të Lidhjes së shkrimtarëve.

DOM NDRE MJEDA. – U lind në Shkodër më 19 nëntor 1866, nga një familje e varfër me origjinë fshatare. Shumë i ri ai hyri në seminarin e jezuitëve të Shkodrës. Pjesën më të madhe të studimeve të tij ai i kreu pastaj në Spanjë, në Poloni dhe në Itali. Si u bë jezuit që profesor në një shkollë të lartë të jezuitëve në Itali, por pas dy vjetësh ai doli nga shoqëria e jezuitëve, apo e nxorën, nuk dihet mirë. Shkaku pse doli nga jezuitët nuk dihet. Në rrethet klerikale u mbajt në heshtje kjo gjë, por gojë më gojë thuhej se për çështje disipline, dhe sepse Mjeda na paska qenë kokëfortë. S'është çudi aspak që këto fjalë t'i kenë hapur vetë klerikët për të mbuluar ndonjë gjë tjetër me to.

Në të vërtetë Mjeda që nevrik dhe kokëfortë në mendimet e tij, por ai që edhe i matur dhe i singërtë,



virtyte këto që s'pajtoheshin me jezuitizmin. Atje urdhrave u duhej bindur verbërisht.

Kështu Mjedën në jetën e tij të pastajme e shohim të ketë kompresion për të vegjlit, t'i dojë edhe t'i mësojë, siç bënte me fshatarët e famullisë së tij, të cilëve u mësonte bujqësi, por me të mëdhenjtë ai zihej lehtë, ose u rrinte larg.

Si doli nga shoqëria e jezuitëve ai erdhi në Shkodër (thuhet se vetëm me 2 lireta në xhep), dhe që andej e dërguan famullitar nëpër fshatrat më të humbura të qarkut të Shkodrës. Më në fund qëndroi për një kohë të gjatë në Kukel, një fshat i vogël pranë rrugës Shkodër-Lesh.

Në vitin 1902, në kongresin e Orientalistëve në Hamburg, ai mbajti një disertacion latinisht mbi shqiptimin e palataleve dhe dialektet e ndryshme të gjuhës shqipe. Një vit më pas ai bashkë me të vëllanë Imz. Lazer Mjeda, Argjipeshkvi i Shkodrës, kishte themeluar shoqërinë letrare "Agimi" në Shkodër. Kjo shoqëri kishte pikëpamje divergjente në çështje gjuhe dhe literature me shoqërinë

"Bashkimi" që ishte themeluar në Shkodër më 1899 nga Imzot Preng Doçi, Pater Gjergj Fishta, Dom Ndoc Nikaj etj..

Më 1908 Mjeda mori pjesë në Kongresin e Manastirit të përfaqësues i shoqërisë "Agimi". Atje ai paraqiti mendimet e tij mbi çështjen e alfabetit, dhe thuhet se në diskutim e sipër u zu me Fishtën.

Mjeda ishte i mendimit që për çdo tingull të gjuhës të caktohet një shkronjë më vete, por mendimi i tij s'u pranua.

Më 1917 që anëtar i "Komisës Letrare" të Shkodrës, ku u caktuan rregullat kryesore të ortografisë shqipe.

Si u formua shteti shqiptar pas vitit 1920, ai që si deputet i Shkodrës gjer më 1924, por pas ardhjes së Zogut në fuqi ai u tërhoq definitivisht në jetën e tij private në famullinë ku shërbente. Mjeda ka pasur korrespondencë me albanologët Gustav Meyer, Norbert Jokl dhe Holger Pedersen. Ai me këta diskutonte mbi problemet e ndryshme të gjuhës sonë, për studimin e së cilës shkroi një pjesë të madhe të jetës së tij. Megjithatë Mjeda nuk na ka lënë shumë studime të shkruara në gjuhën shqipe. Pak vjet përpara se të vdiste, jezuitët e thirrën pranë kolegjit të tyre në Shkodër si profesor të gjuhës shqipe. Ai vdiq më 1 gusht 1937, dhe kleri deshi ta varroste pa ndonjë nderim të veçantë, por studentët e Shkodrës ndërhyjnë tek Argjipeshkvi i Shkodrës, Imzot Gaspër Thaçi, i cili me shumë vështirësi pranoi propozimin e studentëve, të cilët deshën t'i bëjnë një varrim me ceremoni. Karakteristike është edhe nekrologjia e dobët që shkroi "Hylli i Dritës" për Mjedën, pas vdekjes së tij. Duket se ndonjë faj i vjetër dhe i rëndë e kishte vënë prej kohësh Mjedën në pozitat e të dënuarit në gjirin e klerit katolik.

Mjeda ka shkruar pak dhe fama e tij lidhet kryesisht me poezinë e tij lirike. Më 1917 ai botoi në Vjenë poezitë lirike të rinisë së tij në një volum të vogël me titull "Juvenilja". Kjo u ribotua edhe një herë më 1928.

Më 1921 botoi në "Hyllin e Dritës" një poemë me titull "Lissus". Poema në dymbëdhjetë tingëllime këndon lavditë e antikitetit të qytetit të Lezhës. Më 1928 kjo poemë u botua më vete. Një tjetër poemë si kjo, që këndon lavditë e antikitetit të Shkodrës, u botua më 1939. Kjo mban titullin "Skodra", ka vetëm njëmbëdhjetë tingëllime, dhe ka mbetur e pa kryer.

Mjeda kishte projektuar të bënte edhe dy poema të tjera të këtij lloji: "Dyrrhachium" dhe "Apollonia", por me sa duket këto të dyja as që i filloi fare. Katër vjersha lirike të tij gjenden të botuara në "Lingua Albanese" të Fulvio Cordignanos, dhe dy të tjera në revistën "Leka" të vitit 1937. Njëra nga këto lirika me titull "Lirija", shkruar dhe përpunuar në vitet 1901-1911, është një nga lirikat e tij më të përparuara nga ana e pikëpamjeve politike, dhe një nga më të fuqishmet nga ana artistike.

Më 1934 ai botoi në Shkodër një studim të vogël gjuhësie, me titull "Vrejtje mbi artikuj e premna pronës të gjuhës shqipe". Çështjet që trajton studimi në fjalë janë rrahur dhe analizuar me kompetencë. Disa nga këto çështje, si p.sh. çështja e artikullit, është zgjidhur këtu definitivisht dhe sot e trajtojnë artikullin në mënyrë jo të drejtë shkencore. Edhe për çështjen e përemrave pronorë Mjeda këtu ka dhënë vijën e drejtë mbi të cilën duhen trajtuar dhe shtruar këta.

Në prozë Mjeda ka bërë disa përkthime fetare, nga të cilat shquhet "Historija e Shejtë", për stilin e saj të qartë e konciz, dhe për gjuhën e saj me konstrakte krejt sipas natyrës së shqipes. Të bukura janë edhe pjesët e këndimit që ai ka shkruar nëpër disa libra shkollorë.

"Juvenilia" dhe sentimentit i saj

Por vepra e tij kryesore mbetet gjithmonë "Juvenilia".

Juvenilia, siç e thotë edhe vetë titulli, përmbledh lirikat e rinisë së poetit. Këtu sentimentit i tij është më i fortë, fantazia më e gjallë; këtu edhe ekspresioni i tij është më i plotë. Juvenilia tematikën e saj e ka marrë pjesërisht nga çështjet patriotike, pjesërisht nga natyra ose jeta e thjeshtë fshatare, siç është poema e bukur "Andra e Jetës".

Kështu Juvenilia bën periudhën e parë të krijimeve artistike të Mjedës. Këtu poezia e tij është nën influencën e formës klasike dhe nën influencën e brendisë romantike; por pranë notës dominante të romanticizmit të tij ngrihet shumë herë një notë realizmi çuditërisht e fortë, sidomos kur ai përshkruan natyrën, ose kur përshkruan dashurinë e Zogës në

poemën “Andrra e Jetës”. Në periudhën e dytë të krijimeve të tij artistike Mjeda bëri një kthesë të thellë: tani edhe forma edhe brendia e artit të tij janë nën influencën direkte të klasicizmit. Poemat “Lissus” dhe “Scodra”, plot me mitologji legjenda dhe ngjarje antike të vendit tonë, plot me emra të kohëve ilire e para-ilire, janë bërë qendra e prodhimit letrar të kësaj periudhe të dytë të artit të Mjedës. Këtu frymëzimi i tij shpeshherë bie: shpeshherë këtu fjala, vargu, ritmi e muzikaliteti oshëtin me pompozitet, por zemrën ta lë të ftohtë, bosh: forma predominon.

Kjo nuk do të thotë se këto poema të tij janë bërë fare formë e thatë: qëllimi i poetit ishte që të këndojë madhërinë e antikitetit të vendit tonë, dhe kjo, kur poeti arrin ta ndiejë dhe ta ndriçojë me evokime historike të gjalla, tingëllimet e tij transformohen në një poezi me karakter himnesh solemne. Studimet e tij të forta mbi klasikët grekë e latinë, njohuritë e mëdha që ai kishte mbi mitologjinë dhe historinë e ilirëve, i jepnin dorë mjaft në këtë lloj poezie.

Megjithatë forca e tij poetike mbetet gjithmonë te “Juvenilja”. Atje Mjeda di të mallëngjehet për atdheun, kur gjendet larg tij, dhe këtë mallëngjim di ta kthejë në një lirizëm elegjiak që të prek:

“Nder njikto vende për bukuri
Dhént'ëm i shuemi jam tuidishrue;
N'gjytetet'hueja, porsi n'shkreti,
Rrijtugjimue

A e bukur fusha kùr çilë prendvéra
Lulzim ka kopshti kùr lulet dalin;
E drandofilles nder fushë tret'ëra
E perté malin.

Por gjith këto t'mira ngushëllim nuk m'apin:
Peratdhét'emin zemra po m'shkrihet;
Njatjékùr mendja lëshon ndo'j herë vrapin
Shendi i pertrihet...” (“Juvenilia”, Malli për Atdhe)

Malli për atdheun që ka prekur thellë ndjenjat e tij, ka ndezur fantazinë e tij, ia kujton gjallë poetit malet e fushat, kasollet, lumenjtë, çdo bimë e çdo gur që ka atdheu i tij: këto ai i njeh dhe i dashuron si njerëzit e familjes, dhe nga larg i thërret me emër:


“O bjeshk' o male, fusha t'bekueme,
Ku vetë herherna për shetishkoshe;
O Maranaji, o Buen 'e mbëlueme
Me bimë gjelbroshe.

Kùr kam me u gëzua? Nder njatokësolla
Ma e pagj'te e kandshmem'udukte jeta;
Nder dhenat'hueja, ku mbrapa u solla,
Veç trishtim gjeta.

Në këtë mallëngjim romantik me ngjyra lokale aq të forta ndjenjat e Mjedës bashkohen me ato të Naimit te “Bagëti e Bujqësi”. Sa i përngajnë njëri-tjetrit këta dy poetë në dashurinë e tyre për natyrën, për gjërat e sendet që ekzistojnë në atdheun e tyre. Mjeda ndenji shumë jashtë atdheut, udhëtoi shumë nëpër vise të huaja, por dëshira e kthimit në atdhe s'e la të pushojë askund; dhe këtë dëshirë ai e bëri poezi. “I tretuni” i tij që nga mërgimi flet edhe me zogjtë që i fluturojnë mbi krye: shpreson t'i bien ndonjë lajm nga atdheu, shpreson të jenë zogjtë e dashur të atdheut të tij:

“O lejlek, o shpend udhtëar,
Qi prej slargutjëtui mbërri,
Pashnjat frymë qi merr e t'bàr,
Nalu 'j herë n'njiket shkreti,
Nji fjalë t'vetmedue me t'pvetë,
O lejlek, o shpend i shkretë.

Ndoshta ti kah jétuiardhë
Atdhént'emin e kalove,
Fushat t'ona me krah t'bardhë
Kodrat t'ona i kerkove;
Ndoshta n'Drinké la ata flëtë,
O lejlek, o shpend i shkretë.
(I tretuni, pj. IV).



PËRMBYSJA E SISTEMIT KOMUNIST, 4 NËNTOR 1990

(Promovim libri:

NËNTORI I BARDH -25 vjetorit të Meshës së Parë, - Katedralja Shën Shtjefnit, Shkodër 2015).

Ndërsa titulli i librit “Nëntori i Bardhë” është mjaft domethënës pasi historia e popullit tonë përmban në memorien e saj nëntor të rëndësishëm, atë të Skënderbeut dhe të Ismail Qemalit, e nëntori i 1990.

Botimi i këtij libri vjen menjëherë pas një seri aktivitete fetare, kulturore dhe shkencore të organizuara me rastin e 25 vjetorit të Meshës së Parë, në përkujtim të asaj ngjarjeje madhore e të paharrueshme për besimtarët shkodranë dhe shqiptarë, 4 nëntorin e vitit 1990, duke i pasqyruar hollësisht ato. Logoja e këtij 25 vjetori është simbolikë në vete mjaft mirë e menduar. Çinari kjo pemë me rrënjë të thella dhe ngulitura fort në tokë, më një trung të fortë dhe degët e shpërndara me gjethe plot jetë. Por çinari në Varrezat e Rrmajt ka histori më vete, rrënjët e tij u ushqyen me gjak martirësh, jetë të prera në mes, me thirrjet në frymën e fundit “Rrnoft Krishti Mbret, Rrnoft Shqipnia”. Ndërsa titulli i librit “Nëntori i bardhë” është mjaft domethënës pasi historia e popullit tonë përmban në memorien e saj nëntor të rëndësishëm, atë të Skënderbeut dhe të Ismail Qemalit, e nëntori i 1990 është i bardhë se përmbante shpresën e bardhë për një të ardhme krejt tjetër për popullin e shumë vuajtur shqiptar duke besuar tashmë i lirë tek Zoti. Citoj këtu Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv i Shkodrës në fjalën e tij përshëndetëse: “Kështu pra, sot po kremtojmë guximin e këtij populli për ta ri-

përvetësuar identitetin dhe dinjitetin e vet”.

Lufta kundër fesë në Shqipëri zgjati për rreth 50 vjet. Gjatë këtyre viteve u zhvillua një proces jo i menjëhershëm, por i shtrirë historik, gjatë të cilit shteti komunist veproi dhe hartoi platforma politike, gjithnjë në përputhje me kushtet konkrete të vendit, dhe zbatoi metoda antifetare, kryesisht antikatoike, tepër të sofistikuara. Klerikët e Kishës Katolike, gjatë kësaj periudhe, përfaqësonin në shkallën më të lartë, kundërshtimin qytetar, qëndresën paqësore, guximin për të mos i tradhtuar idealet e veta, si njerëz të kushtuar Hyjit; për të mos i tradhtuar idealet kombëtare, pavarësisht çmimit tepër të lartë, jetës.

Era e ndryshimeve po ndjehej në Shqipëri, por për fat të keq, ky ndryshim, më shumë se sa rezultat i një përmbysje paqësore të drejtuar nga forcat opozitare (të cilat ende nuk shfaqnin asnjë shenjë organizimi të qartë), ishte një ndryshim që po ndodhte nga lart, nga kasta drejtuese komuniste e diktaturës, imponuar nga ndryshimet e thella gjeopolitike që po ndodhnin në Europën Lindore.

Megjithatë, në segmente të caktuara të reformës së pritshme, dhe në ndonjë pjesë të vendit, disa gjëra komunistëve u dolën jashtë kontrollit të tyre. Pikërisht në aspektin e lirisë fetare, ndryshimi ka qenë shumë më i shpejtë se sa dëshironin “kontrolluesit komunistë të reformës”: ngjarjet që ndodhen në Shkodër, më 4 dhe 11 nëntor 1990, pikërisht në segmentin më të persekutuar të popullit shqiptar, respektivisht, komunitetin katolik,



përmbysën në një formë, le ta quajmë revolucionare, çdo parashikim dhe plan për hapje të ngadalshme dhe të komanduar nga lart.

Sikur reforma në aspekte të tjera do të pësonte fatin që pësoi në Varrezat e Rrmajit në Shkodër, ndoshta e ardhmja dhe shndërrimi demokratik në Shqipëri do të merrte karaktere të ndryshme nga çfarë mori në të vërtetë në të gjithë këtë periudhë post diktatoriale.

Thënë ndryshe, përmbysja e sistemit komunist nuk do të ishte një revolucion paqësor i drejtuar nga ish komunistët, por do të ishte një përmbysje e njëmendtë reformuese e drejtuar nga forcat opozitare. Pyetja më e vlefshme në këtë rast është se: a ekzistonin me të vërtetë forca të tilla, a ishin ende gjallë ata ? Ata forca ishin shkatërruar në themel dhe çfarë kishte mbetur ishte vetëm një kopje e dobët e elitës pro-europiane dhe pro-demokratike shqiptare. Pjesë e këtij shkatërrimi të elitës shqiptare është edhe shkatërrimi institucional dhe i burimeve humane të Kishës Katolike në Shqipëri.

Goditja ndaj Kishës Katolike ka qenë aq e ashpër, sa megjithëse kjo kishë arriti të shfaqej më 1991 me strukturën organizative skeletore, në fakt kjo strukturë nuk ishte veçse një hije mjaft e zbehtë e Kishës Katolike shqiptare në vitin 1944. Dëmet që ajo kishte pësuar ishin të pariparueshme, dhe ndoshta do të duhen dekada të tëra për të risjellë në veprim forcën dhe kapacitetin intelektual të saj dhe pozicionin e saj parësor në drejtimin intelektual të Shqipërisë.

“Nën hijen e çinarit” Mesha e parë publik

Pjesa I e librit nën titullin “Nën hijen e çinarit” na njeh me logon e këtij aktiviteti jubilar dhe me kujtimet e Dom Simon Jubani, këtij kleriku guximtar dhe me predikimin që mbajti ai atë ditë. Në këto kujtime ai shprehet me nostalgji për datën 4 nëntor 1990 kur e thërrasin në shtëpinë e tij sepse populli ishte mbledhë në varrezat katolike të Rrmajit dhe po e priste për meshë. Kjo ishte një datë historike për popullin shkodran dhe shqiptar. Mesha e improvizuar u dha në praninë e rreth 300 vetëve. Fotografitë e mjeshtrit Angjelin Nënshati e

ilustrojnë mjaft mirë emocionin e asaj dite. Do të shtoja këtu një statistikë të cituar nga monografia ime shkencore “Kisha Katolike dhe shteti komunist në Shqipëri”: “Viti 1991 e gjeti Kishën Katolike në Shqipëri me 1 ipeshkëv (nga 7 ipeshkvij në vitin 1945) ; 20 priftërinj dioqezian (nga 93 priftërinj dioqezian në vitin 1945) ; 12 klerikë (nga 94 klerikë në vitin 1945) ; 40 klerikë (nga 239 në vitin 1945) ; asnjë famulli (nga 231 në vitin 1945). Kjo statistikë flet qartë për humbjet e paimagjinueshme për mendjen e njeriut me kulturë perëndimore, që pati ky kler në vitet e diktaturës.”

Kalendarin e aktiviteteve

Në pjesën II njihemime kalendarin e aktiviteteve të organizuara nga Arqipeshkvia Metropolitane Shkodër-Pult dhe Famullia e Shën Shtjefnit dhe me punën e bërë në dy vendet që ishin më shumë të lidhura me këtë ngjarje: Varrezat e Rrmajit dhe Katedralja e Shkodrës e ndërtuar në vitin 1865 si krenaria e katolicizmit shqiptarë. Varrezat i janë nënshtruar punës restauruese ndërsa oborri i Katedrales punës ndërtuese të një vizioni të ri.



Dom Ndoc Nika “Historia e Shqypnis”

Një vend të dukshëm (edhe nëpërmes fotove ilustruese) në libër zënë aktivitete fetare dhe kulturore të organizuara për nder të këtij viti jubilar (pjesa III), e veçanërisht promovimi i ribotimit të librit të Dom Ndoc Nikajt, ku morën pjesë shumë studiues të fushave të ndryshme shkencore, të cilët me kumtesat e tyre paraqitën rëndësinë e pazëvendësueshme të këtij volumni. Promovimi i këtij libri i organizuar nga Arqipeshkvia Metropolitane Shkodër-Pult dhe Famullia e Shën Shtjefnit u bë në Shkodër me pjesëmarrjen e studiuesve nga Universiteti i Shkodrës dhe në Prishtinë me pjesëmarrjen e studiuesve të Institutit Albanologjik të Prishtinës, ku mes të tjerëve një zbërthim të detajuar të figurës shumë planëshe të D.Ndoc Nikës e bëri akademiku Rexhep Qosja. Arsyeja mendoj që ky aktivitet është bërë pjesë e këtij botimi është se dom Nikaj ishte një apostull i shqiptarizmit, që gjithë jetën ia kushtoi fesë, atdheut dhe kulturës shqiptare dhe gjithashtu personi që kaloi tri pushtete dhe regjimi komunizmi e burgosi në moshën 80 vjeçare duke arritur të vuante vetëm dy vjet e gjysëm për arsye të moshës. Vepra e Dom Ndoc Nikës “*Historia e Shqypnis*” është një kontribut me rëndësi të jashtëzakonshme për historinë e kulturës shqiptare, ndërsa për ne, brezat e mëvonshëm, historian dhe studiues, një burim të rëndësishëm për historinë tonë kombëtare.

Mesha Solemne në Varrezat e Rrmajt

Pjesa IV e këtij libri na njeh me një nga aktivitetet më të rëndësishme të këtij jubileu, ku besimtarë të shumtë u mbledhën për të marrë pjesë në Meshën Solemne në Varrezat e Rrmajt dhe me fjalët përshëndetëse nga autoritet kishtarë dhe shtetërore. I dërguari i Vatikanit, Kardinali Salvatore de Georgi, pasi mbërriti në Shkodër, i shoqëruar nga Arqipeshkvi Angelo Massafrà dhe famullitari Dom Artur Jaku, ndër të tjera, vizitoi ish-burgun e degës së brendshme, sot Kuvendi i Motrave Klarise, ku për një kohë të caktuar vuajtën dënimin shumë meshtarë katolik.

Në këtë festë përkujtimore mori pjesë edhe kryeministri i vendit Z. Edi Rama i shoqëruar nga Ministria e Kulturës, Znj. Mirela Kumbaro. Ata me parë vizituan Arqipeshkvinë e Shkodrës, duke u takuar me Kryepeshkvin Imzot Angelo Massafrà, Kardinalin Salvatore de Georgi dhe famullitarin e vendit, për tu vazhduar më pas drejt varrezave të

Rrmajt, ku në pritje të solemnitetit ishin bashkuar me qindra besimtarë të ardhur edhe nga rrethinat e Shkodrës. Mesha solemne e orës 10:00 u udhëhoq nga Kardinali Salvatore de Georgi, shoqëruar nga Imzot Massafrà, Nunci Apostolik Ramiro Moliner Ingles, ipeshkvijtë e tjerë të dioqezave shqiptare si dhe shumë meshtarë nga vendi, Kosova dhe Mali i Zi.

Në Meshë, krahas autoriteteve shtetërore, ishin të pranishëm : Kryetari i Kulteve Ilir Dizdari, Prefekti i Shkodrës Paulin Rodovani, Kryetarja e Këshillit të Qarkut Greta Bardeli, Kryetarja e Bashkisë Shkodrës Voltana Ademi, deputet të Kuvendit të Shqipërisë dhe diplomat të huaj. Nga përfaqësuesit e komuniteteve fetare në Shkodër që ishin të ftuar, i pranishëm ishte Atë Nikolla Petani i Kishës Ortodokse Shqiptare. Në celebrim të Meshës ishin edhe shumë protagonistë të 4 dhe 11 nëntorit të vitit 1990.

Historiku i Varrezave të Rrmajt

Libri mbyllet me pjesën V ku historiani Dr. Dom Nikë Ukgjini na jep një historik të Varrezave të Rrmajtnë Shkodër, monument kulture, vlerë e veçantë që i shtohet kulturës shqiptare. Në këtë studim autori, duke u mbështetur në burime historike na njej me origjinën e këtij emri, i cili sipas tij si toponim figuron që në shek. XVII, ndërsa ceremonitë fetare në Rrmaj mund të kenë filluar që në vitin 1610 dhe që nga ky vit duhet ta ketë zanafillën e vet rikrijimi i këtyre varrezave katolike nga banorët për qytetin e Shkodrës. Sipas studiuesit Dom Nikë Ukgjini: “*Duke parë varret e vjetra që ndodhen në atë varrezë, por edhe ato më të rejat, me syrin e një artisti profesionist, shihet qartë mjeshhtëria e ndërtimit të tyre, që nuk ndryshon shumë edhe nga varrezat e vendeve të ndryshme të Evropës Perëndimore. Kjo tregon se qytetërimi post-osman, në traditën kulturore të qytetit të Shkodrës, ka qenë i fuqishëm e i pranishëm gjatë rilindjes sonë kombëtare.*”

Shteti komunist për t'i zhduk rëndësinë historike të varrezave, i mbylli ato në vitin 1970-72, për t'u rihapur përsëri pas përmbysjes së diktaturës më 4 nëntor 1990, me celebrimin e Meshës së Parë.

Falënderoj të gjithë ato që bënë të mundur botimin e kësaj vepre, veçanërisht Dom Artur Jakun dhe Dom Nikë Ukgjinin për punën e tyre shumë të vlefshme, duke na dhënë kështu një pasqyrim të plotë të këtij jubileu kaq të rëndësishëm për Kishën Katolike Shqiptare dhe mbarë besimtarët shqiptar.

Nertila Haxhia- Ljarja

Kastriot MARKU

Milano

PROPAGANDA FIDE KONTRIBUTI PËR LIBRIN, GJUHËN DHE LETËRSINË SHQIPE

Korpusi i teksteve të vjetra të gjuhës shqipe, relativisht të pakta për nga numri i tyre, përbën materien bazë mbi të cilën mund të përvijohet rindërtimi i vijueshëm i gjendjes së gjuhës shqipe përgjatë Mesjetës. Mungesa shqetësuese e burimeve dorëshkrimore, para së gjithash për shkak të rrethanave historike të kohës, rritet proporcionalisht me këtë mungesë.

Gjuha dhe letërsia shqipe, e veçuar disi prej gjuhëve dhe letërsive simotra evropiane, nuk ishte gjithaq prodhimtare, dhe kjo jo gjithaq prej pazotësisë së saj për t'u identifikuar si e tillë, sa prej faktit real se Shqipëria deri në fillim të shekullit të XX, kur edhe u shpall shtet i pavarur, ishte një provincë e izoluar e Perandorisë Osmane, ku gjuha, shkolla, shtypshkrimi dhe letërsia e saj ishin të ndaluara me ligj. Kuvendet, manastiret, seminarët, uratorët, kolegjet u bënë institucionet që morën përsipër këtë barrë të rëndë, në kushte tejet të rrezikshme.

Vetëm në gjysmën e dytë të shekullit të XIX, kjo gjë me dhe pahir dha shenja gjallese. U hapën shkolla dhe seminare, u themeluan shtypshkronja dhe si rrjedhojë edhe libri shqip tashmë u botua në Shqipëri, sepse pa tipografinë (shtypshkrimin), e

cila është baza e prodhimit dhe e shumëfishimit të librit, nuk mund të bëhej fjalë të kishim një proces letrar normal. Krahas formimit të klerit, para të cilit shtrohej si domosdoshmëri pajisja e tij dhe posaçërisht e nxënësve vendas, kandidatë për meshtarë, me libra liturgjike dhe libra me karakter praktik për mësimin e fesë.

Po ashtu kërkohej njëkohësisht që misionarët e huaj që shërbenin në dioqezat shqiptare, për të mësuar gjuhën vendase duhej që të kishin fjalorë dhe gramatika. Kundërpërgjigja e Kishës romane ndaj Reformës protestante në transferimin e mësimave liturgjike nga latinishtja në gjuhët popullore, në pajtim me kanonet e kishtarë shënon për gjuhën shqipe kultivimin e saj si gjuhë shkrimore, prandaj nuk përbën ndonjë çudi fakti se e gjithë pasuria librare e letërsisë së vjetër shqipe, së paku deri në fund të gjysmës së parë të shekullit të XVIII, vjen e shkruar drejtpërdrejt prej ipeshkvinjve dhe meshtarëve shqiptarë si dhe misionarëve katolikë italianë, botimet e të cilëve janë aprovuar prej Selisë së Shenjtë.

Eqrem Çabej e sqaron mjaft mirë këtë kontekst kur thekson se: “Ndërsa Kundërreforma në viset e Europës së mesme e veriore dhe në vazhdimet e



1 Collegio de Propaganda Fide ampliato da N. S. Papa
Alessandro Settimo.
2 Chiesa dell'Adorazione de Magi in detto Collegio fatta da
N. S. S. S.

COLLEGIO DE PROPAGANDA FIDE.
Per Gio: Francesco Ruffi in Roma alla Pace. 1771 del S. P.

3 Chiesa di S. Andrea delle Fratte.
4 Cappella, e Campanile di detta Chiesa.

9
Gio: Battista Felici del S. P.

tyre perëndimore e lindore shpërtheu përmbi një bazë të hapet edhe me të gjitha armët luftën kundra besimit protestant, në Gadishull të Ballkanit, me islamizmin qysh prej një shekulli kishte dalë një armik i cili po kërcënonte jo vetëm besimin katolik në ato vise ku ekzistonte, si në Shqipëri e Bosnjë, po edhe besimin ortodoks, e kështu pra mbarë krishterimin, edhe po matej tashmë të përfshinte krejt Europën juglindore.

Aty Romës i doli përpara një detyrë e re dhe e një lloji tjetër: sepse kalimi mbarë i disa krahinave të Ballkanit perëndimor në islamizëm donte të thoshte shpëputje njëherë e përgjithmonë prej kishës katolike, madje edhe krejt prej besimit kristian. Në të tilla rrethana u desh që ato armë mendore që ishin përdorur në viset e tjera të Europës kundra doktrinës së Luterit, në këto anë të zbatoheshin kundra shtrirjes së vendeve të mëdha të besimit të ri që po hynte. Ndër këto armë ndërkaq një nga kryesoret - për aq sa e lejonin kanonet e kishës katolike - ishte përhapja sa më e madhe e fjalës biblike në gjuhët e vendit, për t'i vënë gjer diku një ledh ftohjes e largimit përherë e më të madh prej besimit të vjetër.»

Përfundimisht Buzukun, librin e të cilit e kemi pa kopertinën dhe frontespicin ku shënohet leja e botimit, viti dhe vendbotimi i tij, të gjitha botimet e tjera si të Lukë Matrangës, Pjetër Budit, Frang Bardhit, Pjetër Bogdanit, Francesco Maria Da Leçes, Gjon Nikollë Kazazit, Akteve të Kuvendit të Arbnit etj., kanë të stampuar në ballinën e tyre "Superiorum Permissu", ose „Con Licenza Superiori“ leje e posaçme aprovuese e dhënë prej eprorëve ose prej institucioneve kishtarë. Tipografia e Vatikanit e ka zanafillën në vitin 1561 me Paolo Manuzio. Tipografia e re që themeluar nga Sisti V me kushtetutën Eam Semper ex Omnibus më 27 prill 1587.

I njëjti Papë në reformimin e Kurisë Romane me kushtetutën Immensa aeterni Dei të datës 22 janar 1588 e kompletoi me një digaster special të përbërë prej pesë kardinalësh i cili do të ndiqte me kujdes tipografët, rishikuesit të librave të çdo kombësie. Koncilio i Trentos i aktualizoj çështjet e reformës së librave liturgjikë përmes autoritetit papal, gjë që u realizua në periudhën midis viteve 1568 dhe 1614, nën pontifikatin e Pio V, Gregorio XIII, Clemente VIII dhe Paolo V. U botuan Catechismo Romanum (1566), Breviarium Romanum (1568), Missale Romanum (1570),



Martyrologium Romanum (1584), Pontificale Romanum (1596), Caeremoniale Episcoporum (1600) dhe Rituale Romanum (1614).

Botimi i Ritualit Roman shënon përfundimin e procesit të rishkimit të këtyre teksteve. Do theksuar veçanërisht se vetëm 7 vjet më vonë, këtë ritual do e përkthente në shqip Imzot Pjetër Budi, ndërkohë që kroatët e përkthejnë atë vetëm në vitin 1640. Periudha prej 140 vjetësh nga përfundimi i Konçilit të Trentos (1563) deri në mbajtjen e Kuvendit të Arbënit (1703) shënon një periudhë të gjatë të mbushur me përpjekjet të mëdha e të mundimshme nga kleri katolik shqiptar në kushte thuajse mbijetetese për të përmbytur vënien në zbatim të dekreteve konçiliare.

Do të jetë pikërisht Kuvendi i Arbënit, mbajtja e të cilit u realizua me interesimin e drejtpërdrejtë të Papa Klementit XI, ai që do të përmbyshë bindshëm institucionalisht përtëritjen besimit të krishterë katolik në territoret shqiptare në kushte tejet të vështira nën pushtimin turk, duke shënuar kështu në një farë mënyre fillimet e procesit të



Rilindjes Kombëtare, e cila sipas gjasave merr më pas shtysën vendimtare në mjediset arbëreshe të Italisë për të pasur më tej efektete e saj brenda vendit. Më 1626, Propaganda Fide themeloi shtypshkronjën e saj të emërtuar „Poliyglotta“, me qëllim shtypjen e librave kishtarë në gjuhët e popullsisë të vendeve në të cilat ishin instaluar misionet.

Shtypshkronja e dëshmoi edhe ajo rolin e saj misionar pikërisht në botimin e saj të parë Fjalorin gjeorgjisht-italisht, botim i vitit 1629. Gjashtë vjet më pas (1635), ajo do të botojë edhe fjalorin e Frang Bardhit dhe vitin pasues (1636) do të ribotojë Dottrinën e Pjetër Budit të vitit 1618, përkthim të katekizmit të Kardinal Roberto Bellarmino-s, për të vijuar të botojë kështu rreth 35 libra deri në fund të shekullit të XIX, kur më në fund në vitin 1870 jezuitët do të sjellin në Shkodër shtypshkronjën e tyre, e cila në fillim u quajt latinisht Typographia Immaculatae Conceptionis B.M.V. dhe më pas në shqip nën disa emërtime si: Shtypshkroja e Zojs xanun pa kur leqe, Shtypshkroja e Kolegjs Papnore, Shtypshkroja e Zojs xanun pa mkat t'riedhshem, dhe në fund Shtypshkroja e Zojës së Papërlyeme, dhe që në vitin 1876 do të botojë librin e parë shqip Dottrina e Kerscten të Engjëll Radojës.

Të gjitha këto botime deri në gjymën e dytë të shekullit të XIX, me përjashtim të librit të parë shqip që është quajtur Meshar, botuar në vitin 1555, autori i të cilit është Gjon Buzuku, për të cilin studiuesit ndajnë mendime të ndryshme në lidhje me vendin e botimit të tij, si dhe botimeve të para të veprave të Pjetër Budit, Dottrina Christiana, Rituale Romanum et Speculum Confessionis dhe Pasëqyra e t'rrëfyemit veprës së Pjetër Bogdanit Cuneus Prophetarum, e cila fillimisht botohet më 1685 në Padova, për t'u ribotuar edhe më 1691 dhe 1702 në Venecia, të gjitha botimet e tjera; ato të Dottrina Christiana të Pjetër Budit (1636, 1664, 1868), më 1635 Frang Bardhi: Dictionarium latino-epiroticum, që i bie të jetë vepra e parë në fushën e albanologjisë botohen këtu.

Këtu botohen më 1706, aktet e Kuvendit të Arbënit nën titullin: Concili Provinciaali o Cuvendi i Arbenit, të cilat ribotohen edhe në vitet 1868 dhe 1872. Më 1716, P. Francesco Maria Da Leçe boton: Osservazioni gramaticalli nella lingua albanese, dhe më 1743 Gjon Nikollë Kazazi boton: Breve copendio della dottrina cristiana. Pra të gjitha këto botime janë realizuar në shtypshkronjën e Propagandës Fide në Romë dhe me shpenzimet e Propagandës Fide.

Rroftë Krishti Mbret! Rroftë Shqipnia!

Në Seminarin Ndërdioqezan Shqiptarë me 05/03/2016 u përkujtua shtatëdhjetë vjetori i martirizimit të rektorit Atë Daniel Dajani S.I., zëvendës rektorit Atë Giovanni Fausti S.I., seminaristi Mark Çuni. Bashkë me ta po atë ditë u vra edhe Atë Gjon Shllaku O.F.M., e disa të tjerë laikë me akuzat; propagandë e agjitacion. Në këtë ditë, që ishte dita e miqve të Seminarit, u vu në skenë një dramë e shkruar nga seminaristi Mark Pashkja dhe e interpretuar nga disa seminaristë.

Në qendër kishte mbi të gjitha jetën e Mark Çunit, hyrja për meshtarë, kthimi i tij në burg deri për të arritur në fjalët e fundit: “I fali të gjithë që më kan gjykue, dënue, si edhe ata që do t'm'ekzekutojnë! [...] Rroftë Krishti – Mbret! Rroftë Shqipnia!”.




Ishte i pranishëm arqipeshkvi i Shkodër – Pult-it Imzot Angelo Massafra, shumë meshtarë me pjesëtarët e famullive të tyre, pothuajse nga e gjithë Shqipëria, disa persona nga Kosova dhe delegatët nga Seminari i Kietit të Italisë.

Tek të gjithë u përcoll shembulli i fesë së martirëve tanë dhe shkoi në vend ajo që vet Krishti tha: “Lum ata që salvohen pse kryejnë çka Hyji kërkon sepse e tyre është Mbretëria e qiejve. Të lumët ju kur t'ju shajnë e

t'ju salvojnë dhe kur, për shkakun tim, t'i thonë të gjitha të zezat kundër jush, por në rrenë! Gëzohuni e galdoni, sepse i madh do të jetë shpërblimi juaj në qiell! Jo po, kështu i salvuan edhe profetët para jush!” (Mt 5, 10-12). Së bashku me pjesëtarët e Seminarit që e organizuan këtë ngjarje, ishin edhe Rozafa Expresion nën drejtimin e mjeshtrit zotëri Zef Çoba, të cilët interpretuan shumë këngë korale, e disa poezi të interpretuara nga artistë të ndryshëm.

Gjithçka kulmoi me meshën e shenjtë të udhëhequr nga Imzot Angelo Massafra, ku na e dha lajmin e lumturimit të tridhjetetë martirëve shqiptarë, që do të ndodhë kah fundi i këtij viti.





Dr. Dom Nikë Ukgjini

KISHA KATOLIKE
NË TREVAT SHQIPTARE

QBSHJ, Tiranë 2016



Ana Lalaj

PRANVERA E RREJSHME
E '56-s

Infbotues,
Tiranë 2015



Markus Peters

SHTËPIA BOTUESE MË E
VJETËR

QBSHJ
Tiranë, 2016

KUMBONA E SË DIELËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë

(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,

Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

KUMBONA E SË DIELËS

Viti XXX, nr. 3/4 (483-484) Mars - Prill 2016